



USHTRIA



Viti i 77-të i botimit Nr. 51 (827906)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 27 dhjetor 2024

Ministri Vengu: Mirënjohje për familjen e madhe të Mbrojtjes,
ambasadorët më të mirë të Atdheut në sfida dhe paqe!



Në këtë ditë të shënuar, ju uroj përzemërsisht 99 - vjetorin e Krijimit të Forcës Detare Shqiptare!

Kjo ditë përfaqëson një histori të lavdishme, sakrificë dhe përkushtimi në shërbim të sigurisë së vendit dhe mbrojtjes së sovranitetit detar të Republikës së Shqipërisë.

Forca Detare Shqiptare ka një histori të pasur dhe me vlera, që fillon 99 vjet më parë, në 1925, kur u hodhën themelet e saj për mbrojtjen e integritetit detar të shtetit shqiptar.

Gjatë dekadave, kjo forcë ka kaluar sfida të shumta, duke u përshtatur dhe forcuar përballë ndryshimeve historike, teknologjike dhe gjeopolitike.

Nga krijimi i bazave të para detare deri te ngritja e modernizimi i saj, Forca Detare ka qenë gjithmonë në ballë të sigurisë dhe mbrojtjes së ujërave territoriale, duke mishëruar guximin, përkushtimin dhe shpirtin e sakrificës që karakterizon detarët shqiptarë.

Në këtë ditë të shënuar, një urim i veçantë shkon për Kontingjentin VI që aktualisht shërben me dinjitet dhe profesionalizëm në kuadër të aktivitetit të NATO-s në detin Egje.

Kontributi Juaj në përballimin e sfidave të sigurisë, zbatimit të ligjshmërisë në det, trafikimit të paligjshëm si dhe shpëtimit të jetëve në rrezik është një dëshmi e përkushtimit të vendit tonë ndaj NATO-s, Bashkimit Evropian, stabilitetit rajonal, sigurisë e mbrojtjes së përbashkët si dhe vlerave demokratike që ne përfaqësojmë.

Ju po bëni krenarë jo vetëm Forcën Detare, Forcat e Armatosura, por edhe gjithë kombin shqiptar.

Gjithashtu, në këtë përvjetor të 99-të, dua të vlerësoj punën e palodhur të detarëve që kanë shërbyer ndër vite në Forcën Detare shqiptare.

Me përkushtimin dhe sakrificat e tyre, ata kanë ndërtuar themelet e një force të fortë, të disiplinuar, të respektuar dhe kontribuuese e paqes dhe sigurisë për hapësirat detare të Republikës së Shqipërisë, në rajon dhe më gjerë.

Trashëgimia e tyre është burim frymëzimi për brezat e rinj, ndërsa kontributi i tyre mbetet i përjetshëm dhe i vlerësuar për jetë në historinë dhe traditat e Forcës Detare shqiptare.

Në përballje me sfidat e reja të sigurisë, ju garantoj se përveç investimeve në vijim në kapacitetet njerëzore, modernizimi i mëtejshëm i Flotës Detare në armatim, sisteme, pajisje dhe infrastrukturë do të zhvillohet gradualisht dhe sipas planeve të zhvillimit.



SHSHP të FARSH, gjenerallejtënant Arben Kingji uron 99 - vjetorin e Krijimit të Forcës Detare



Ky modernizim do të fokusohet për përmirësimin e sistemit të integruar të vëzhgimit të hapësirës detare, të kapaciteteve operacionale, kapacitetet e Qendrës së zhytjes, si kapacitet kombëtar, si dhe investime në infrastrukturën e bazave kryesore dhe ato ndihmuese të flotës detare.

Këto investime, përveç mbështetjes së interesave strategjike, do të ofrojnë më shumë kapacitete dhe infrastrukturë për NATO-n dhe aleatët tanë strategjikë, si dhe do t'i ofrojë Forcës Detare/Rojës Bregdetare Shqiptare më shumë ndërveprim, bashkëpunim dhe kapacitete operacionale detare.

Duke përfunduar, ju falënderoj për devotshmërinë dhe profesionalizmin që tregoni çdo ditë, dhe ju inkurajoj të vazhdoni të kontribuoni me përkushtim në realizimin e misionit, në bashkëpunim me NATO-n dhe institucionet e tjera me interesa në hapësirën detare të Republikës së Shqipërisë.

Shpreh bindjen se të gjithë së bashku, do të punojmë me profesionalizëm, me qëllim që t'u përgjigjemi me sukses sfidave të kohës.

Trupat e Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë (bkl) i bashkohen misionit të Kontingjentit KFOR - 5

Në mjediset e Forcës Tokësore u zhvillua ceremonia e përcjelljes së trupave të Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë (bkl), të cilët do të shërbejnë në përbërje të Batalionit Kinetik, në Komandën Rajonale Perëndimore, Pejë, Kosovë. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast morën pjesë: komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, komandanti i Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë, kolonel Xhevahir Kërzhaliu, shefa nga Shtabi i FT-së dhe i bkl etj. Duke marrë fjalën në ceremoni, komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, pasi i uroi ushtarakëve pjesëmarrës suksese në mision, ndër të tjera theksoi: “Kam besim të plotë në vlerat tuaja morale, profesionale dhe mbi



të gjitha në përkushtimin tuaj. Ju shkoni sot në Kosovë me dinjitet, pasi atje do të gjeni emrin e mirë që kanë krijuar kolegët tuaj, që janë aktualisht në detyrë. Jam i bindur se me punën dhe me përkushtimin tuaj, do ia dilni mbanë ashtu siç ia keni dalë gjithmonë në çdo

detyrë, stërvitje apo trajnim.”

Në përfundim të fjalës së tij, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia i siguroi pjesëmarrësit e kontingjentit KFOR - 5, se Forca Tokësore, Shtabi i Përgjithshëm dhe Ministria e Mbrojtjes do të jenë gjithmonë në kontakt me ta dhe pranë



tyre, për çdo problem apo nevojë që do të kenë.

Ceremonia përfundoi me një foto të përbashkët. Me nisjen e këtij kontingjenti, Forca Tokësore shton kontributet e saj në interes të paqes dhe sigurisë rajonale.

Ministri Vengu: Mirënjohje për familjen e madhe të Mbrojtjes, ambasadorët më të mirë të Atdheut në sfida dhe paqe!

Me rastin e festave të fund vitit në auditoriumin e Ministrisë së Mbrojtjes, u organizuan ceremoni festive me fëmijë të personelit ushtarak, të cilët ndodhen në misione jashtë vendit. I pranishëm ishte ministri i Mbrojtjes, z. Piro Vengu, shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralletenant Arben Kingji, komandantë forcash si dhe familjarë të tyre, të cilët komunikuan dhe shkëmbyen mesazhe urimi nëpërmjet platformave online.

Ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes u veshën me ngjyrat e harmonisë dhe dashurisë nga fëmijët, ndërsa të dashurit e tyre, me mall e emocione, përcollën mesazhe nga Sudani i Jugut deri në Letoni, nga Egjipti deri në Bullgari.

Efektivët tanë sot ngrenë lart e me dinjitet dhe krenari flamurin e Shqipërisë në misione si Kosovë, Bullgari, Letoni, Turqi, Egjipt, Sudan i Jugut, Irak, Bosnje-Hercegovinë.

“Kjo është një sakrificë e përditshme që na bën edhe më të bashkuar në këtë periudhë festive, - u shpreh në fjalën e tij të rastit ministri i Mbrojtjes Vengu.

Mirënjohje dhe krenari për gjithë familjen e madhe të mbrojtjes. Një urim të posaçëm për të gjithë ju që sakrifikoni në vijë të parë, sepse doni dhe mbron ata që lini pas. Mbarësi dhe faleminderit që jeni pjesë e Forcave të Armatosura, këtij misioni, ku motoja ‘Atdheu, Nderi, Detyra’ është lajtmotivi që udhëheq jetën tuaj”, - mbylli urimin e tij ministri Vengu.

Më pas u shpërndanë dhurata për fëmijët e pranishëm dhe nën notat muzikore u mbyll ceremonia me urimin nën një zë: “Ardhtë i bardhë 2025!”.



Ministri Vengu: Ditë krenarie, Shqipëria dinjitoze në arenën ndërkombëtare

Një togë nga Regjimenti i Këmbëorisë së Jugut, mes të cilëve 2 vajza, u nisën për në grup-batalionin e NATO-s në Bullgari, ndërkohë që u kthye nga misioni i KFOR në Kosovë, kontingjenti i radhës i përbërë nga Regjimenti i Operacioneve Speciale.

Në ceremoninë e pritjes dhe përcjelljes së dy kontingjenteve në Zall Herr, morën pjesë edhe ministri i Mbrojtjes Piro Vengu, i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralletenant Arben Kingji dhe komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhehexhia.

Në fjalën e tij, ministri Vengu përgëzoi për përkushtimin trupat që nisen në mision në këtë periudhë festash, pa harruar të vlerësojë edhe sakrificën e familjeve të tyre.

Ministri i Mbrojtjes foli për rëndësinë që ka kontributi i Forcave të Armatosura shqiptare në misionet e NATO-s, jo vetëm për sigurinë, por edhe për rolin dhe prestigjin e vendit tonë në arenën ndërkombëtare. “Prania juaj në dy misione të ndryshme në rajon për të ofruar siguri flet shumë dhe sot është një ditë krenarie dhe reflektimi për të gjithë ne. Misioni juaj, pavarësisht vendndodhjes apo rrethanave, përfaqëson më shumë se detyrë, ai përfaqëson përkushtimin, guximin dhe dinjitetin



e Shqipërisë dhe përmbushja e tij me sukses e di shumë mirë që kërkon sakrificë. Në Bullgari, ju do të kontribuoni në përforcimin e krahut lindor të NATO-s, duke ndihmuar në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në një kohë sfidash të shumta për sigurinë globale. Ne kemi treguar se sa besnikë e të përkushtuar jemi për të plotësuar

detyrimet tona ndaj Aleancës, pikërisht falë kontributit që keni dhënë dhe do të jepni në të ardhmen. Njëkohësisht, ata që kthehen nga misioni i KFOR-it, na sjellin një shembull të shkëlqyer të profesionalizmit dhe përkushtimit, ndërsa keni dhënë kontributin tuaj në një tokë shumë të dashur për ne të gjithë, Kosovën që

aq shumë ka nevojë për kontributin e të gjithëve ne si pjesë e Aleancës së madhe. Ju keni treguar se Shqipëria është një partner i besueshëm dhe i përkushtuar ndaj vlerave të përbashkëta”, - iu drejtua zoti Vengu trupave të rreshtuar, të cilëve iu solli në vëmendje edhe atë çfarë ata përfaqësojnë veçanërisht gjatë shërbimit në misionet jashtë vendit. “Ju nuk përfaqësoni vetëm uniformën që mbani; ju përfaqësoni fuqinë dhe dinjitetin e Shqipërisë në një skenë ndërkombëtare. Në çdo hap të rrugës, ju jeni ambasadorë të vlerave tona kombëtare dhe të qëndrueshmërisë sonë si pjesë e NATO-s”, - e mbylli ministri Vengu fjalën e tij.

Kontingjenti i nisur për në misionin e NATO-s në Bullgari përbëhet nga Regjimenti i Këmbëorisë së Jugut dhe do të shërbejë për një periudhë 6-mujore i dislokuar në rajonin stërvitor të Novo Selos.

Me rastin e 99-vjetorit të krijimit të Forcës Detare/Rojës Bregdetare, në Portin e Vlorës u organizua një ceremoni me pjesëmarrjen e kundëradmiral Adnand Agastra, përfaqësues të pushtetit vendor, përfaqësues të institucioneve që kanë interesa në det si dhe ish-komandantë të FD/RB.

Ky moment historik nderoi trashëgiminë, përkushtimin dhe sakrificat e gjithë atyre që kanë kontribuar për mbrojtjen e sovranitetit të ujërave tona.

Në fjalën e tij të rastit, komandanti i Forcës Detare/Rojës Bregdetare kundëradmiral Adnand Agastra, pasi transmetoi përshëndetjen e ministrit të Mbrojtjes z. Pirro Vengu dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm gjenerallejtënant Arben Kingji me rastin e 99 - vjetorit të FD/RB, theksoi: “99 vite më parë, filloi një udhëtim i ndërtimit të një prej institucioneve më të rëndësishme të sigurisë kombëtare. Sot, ne jemi krenarë për arritjet tona, por edhe të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kemi ndaj brezave të ardhshëm. Forca Detare do të vazhdojë të mbetet një garanci për mbrojtjen e atdheut, stabilitetin rajonal dhe përkushtimin ndaj vlerave ndërkombëtare të paqes dhe sigurisë.

Ndërsa ky përvjetor na afron drejt jubileut të madh të 100 viteve, Forcat Detare vazhdojnë të modernizojnë kapacitetet e tyre dhe të thellojnë bashkëpunimin me aleatët ndërkombëtarë, duke qenë një shtyllë kyçe për sigurinë kombëtare dhe rajonale.

Le të qëndrojmë krenarë për këtë trashëgimi dhe të punojmë së bashku për një të ardhme edhe më të sigurt dhe të ndritur.

Det të qetë dhe erëra të mbara!”, - uroi kundëradmiral Adnand Agastra.



Forca Detare/Roja Bregdetare feston 99-vjetorin e krijimit të saj



“

99 VITE MË PARË,
FILLOI NJË UDHËTIM I
NDËRTIMIT TË NJË PREJ
INSTITUCIONEVE MË
TË RËNDËSISHME TË
SIGURISË KOMBËTARE.
SOT, NE JEMI KRENARË
PËR ARRITJET TONA, POR
EDHE TË VETËDIJSHËM
PËR PËRGJEGJËSINË QË
KEMI NDAJ BREZAVE TË
ARDHSHËM.

Përfundon Kursi funksional i Kërkim - Shpëtimit në zonat urbane

Në ambientet e Bazës së Mbështetjes dhe Emergjencave Civile u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit funksional të Kërkim - Shpëtimit në zonat urbane.

Në këtë ceremoni ishin të pranishëm shefi i Shtabit të Komandës Mbështetëse, kolonel Idriz Kuça, komandanti i BMEC, kolonel Hajdar Gurra dhe efektivë të këtij reparti.

15 efektivët e Kompanisë së Dytë operacionale, për më shumë se katër javë përvetësuan njohuri teorike dhe realizuan veprime praktike për t'iu përgjigjur sa më profesionalisht situatave të tilla si tërmete, shembje objektesh, aksidenteve të ndryshme. Njohja dhe përdorimi i pajisjeve speciale, njohja dhe zbatimi i procedurave për kërkimin e personave të mbetur nën rrënoja, metodat e tërheqjes së të dëmtuarve, janë ndër temat kryesore të trajtuara gjatë këtij kursi. Strukturat e Komandës Mbështetëse kanë zhvilluar kapacitetet e duhura për realizimin e kurseve funksionale, të cilat i kanë për qëllim aftësimin e personelit ushtarak në kryerjen e detyrave funksionale në përgjigje të emergjencave civile.



Ekipi EOD përmbush me sukses detyrën për largimin e municioneve të rrezikshme në zonën e Porto Romanos, Durrës

Një ekip operatorësh EOD të Batalionit të Xhenios u angazhuan në mbështetje të autoriteteve civile në bashkinë Durrës.

Në zonën e Porto Romanos janë gjetur një sasi e konsiderueshme municionesh të paplasura, për të cilën është kërkuar ekspertiza e efektiveve të Kompanisë EOD.

Ekipi përkatës bëri rrethimin e perimetrit të zonës ku do të realizohej operacioni dhe duke zbatuar procedurat e parashikuara në manualët EOD, konstatoi municione të tipit predha topi eksploziv tërhmues 37 dhe 40 mm.

Kryeoperatori EOD, bëri vënien në siguresë të municioneve dhe pasi vlerësoi se ato ishin të lëvizshme, u bë transportimi dhe magazinimi i tyre në depot e batalionit të xhenios, duke garantuar sigurinë e qytetarëve dhe zonës përreth.

Siguria e komunitetit mbetet prioriteti ynë kryesor.





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Krishtlindje, Vit i Ri ... Ditë feste dhe të gjithë janë të prirur të festojnë e të gëzojnë, edhe pse ndoshta me mundësitë e kufizuara për shumë arsye. Aq më shumë kur, pas një jave fiks, duhet të rëndojnë buxhetet familjare me një tjetër festë, këtë herë, të ndërrimit të viteve. Festë tradicionale, pse e bujshme, e injektuar më së shumti gjatë periudhës komuniste. Për ata që nuk e kanë jetuar atë kohë, para vitit 1990, shqetësimi më i madh i familjeve shqiptare ishte furnizimi me ushqime në prag të ndërrimit të viteve. Sigurisht me racion, me tallon. Duke nisur nga mishi, frutat, bulmeti dhe ushqime të tjera. Fatlumët i gëzoheshin gjelit të detit të pjekur në furrë publike. Bakllavatë përgatiteshin vetë në shtëpi, me petët që shpërndaheshin kudo mbi çarçafë që të thaheshin para se të vendoseshin një mbi një dhe me rreshtat e arrave të shtypura me pak sheqer në mes. Gara e numrit të petëve por edhe e rreshtave të arrave, tregonte “mirëqenien” apo “profesionalizmin” e amvisave.

Fatkeqësisht, edhe këto 34 vite, “tryeza plot” mbetet shqetësimi më i madh i shumicës së shqiptarëve. Buxhetet familjare shpenzohen në maksimum për të mbushur rafte e frigoriferë. Krijohet ideja e një paniku të çuditshëm, pa e vrarë aspak mendjen se jeta por edhe festat e tjera vijojnë edhe pas ndërrimit të viteve. Lokalet, resortet apo hotelet lulëzojnë në këto ditë. Prenotime për vetëm një natë, që variojnë nga 50 euro deri në 150 euro për person. Kjo, për të patur “tryezën plot” dhe të ta shërbejë dikush ushqimin. Madje, në jo pak raste, edhe emigrantët tanë që kthehen nga jashtë për të festuar me familjarët, shumica bëjnë këtë zgjedhje. Sigurisht, për familjet shqiptare, mund të jetë “lajm i mirë”, sepse shpenzimet e festës së ndërrimit të viteve, ua heqin të afërmit emigrantë.

Dikur dhe sot në sofrat shqiptare

Një tavolinë e mbushur me të mirat e ‘kohës’ të siguruara me shumë vështirësi, por të gjithë rreth asaj tryeze i lumturoheshin njëri-tjetrit, ndërsa sot tryeza e tejmbushur me të gjitha të mirat, në krye të saj, një zotëri i thinjur fisnikërisht, një baba, një bashkëshort, një vëlla, një shok, një mik. Feston me vetminë e tij ndërrimin e viteve, ashtu si çdo ditë të jetës ‘së tretë’ të tij.

“Tryezat plot” por “zemrat bosh”

Në botën virtuale, sëmundjen e shekullit shpërfaqja e luksit me “tryezën plot” është e lehtë. Shpesh gjyshja ime thoshte: “Barku mbushet edhe me mish, por edhe me bukë thatë dhe askush nuk e vë re”. Zemra është ajo që duket, nëse është bosh apo plot, sepse sytë pasqyrojnë atë çka ai organ i vogël jetëdhënës ndien. Nëse duam të gjejmë paqe, ngushëllohem me “është një fazë që e kalojnë të gjitha shtetet, kombet”. E ka kaluar Italia, Gjermania, Franca, Spanja e shumë të tjera vende. Ndoshta është edhe kështu....

Si është festuar Vitit i Ri në Shqipëri?

Festimet për Vitin e Ri kanë ndryshuar shumë gjatë dy dekadave të fundit në Shqipëri, për sa i përket rëndësisë, ashtu edhe për mënyrën se si festohej kjo ditë. Viti i Ri ishte një nga festat tradicionale që festohej në Shqipërinë e para viteve '90. Ishte koha kur nuk kishte celular, rrjete sociale, për të uruar njëri-tjetrin. “Mjeti” më i përdorur ishte kartolina. Deri pak pas viteve të tranzicionit ende përdorehin kartolinat, ku shkëmbeheshin mes miqsh urimet më të bukura për këtë festë, traditë kjo tashmë në zhdukje.



Sot, urimet mes miqve dhe personave të dashur, nuk bëhen më mes fjalëve, por nga mesazhe virtuale të rrjeteve sociale e telefona celularë. Në Arkivin e shtetit edhe atë personal të koleksionistëve ruhen mijëra kartolina për Vitin e Ri.

Cilat janë kartolinat më interesante dhe jo standarde?

Vigjilja e Vitit të Ri ishte një prej festave më të mëdha popullore gjatë komunizmit, kryesisht për shkak se Shqipëria, nën sundimin e Enver Hoxhës, ndaloi çdo festë fetare. Regjimi totalitar, e çrrënjosi nga tregu dhe nga vetëdija e rinisë ateiste idenë për Plakun e Krishtlindjes dhe e zëvendëson me Babagjyshin e Vitit të Ri. Që prej ringjalljes së festimeve për Krishtlindje, festa e Vitit të Ri ka humbur disi shkëlqimin e dikurshëm. Pas ardhjes së komunizmit kartolinat u bënë standarde, ku shihej “Shqipëria socialiste”, gra dhe vajza “të lumtura” apo imazhe të partisë në pushtet e të udhëheqësit të kohës.



Kartolina e parë shqiptare ka dalë për herë të parë në vitin 1913. Ishte një pikturë, e cila më pas u shndërrua në kartolinë. Ishte momenti kur Ismail Qemali lajmëron për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë dhe më pas ngre Flamurin e Skënderbeut, nga ballkoni i shtëpisë së Flamurit, në Vlorë. Autori i kësaj pikturë ka mbetur anonim, por ajo kartolinë është punimi i parë dhe i vetëm që tregon momentin e ngritjes së Flamurit, më 28 Nëntor të vitit 1912. Kartolina është prodhuar vetëm një vit pas shpalljes së pavarësisë. Pas ardhjes së komunizmit kartolinat u bënë standarde, ku shihej “Shqipëria socialiste”, gra dhe vajza “të lumtura” apo imazhe të partisë në pushtet e të udhëheqësit të kohës. Përpos vështirësive të kohës e veçanta qëndronte te veprimtaria krijuese në prag të Vitit të Ri, që shpenzohej duke sfiduar rrethanat e vështira financiare.

Një tjetër kartolinë e veçantë është ajo e 1973, ku një baba i uronte festat djalit të vet.

Si festojnë sot Shqiptarët?

Ka zbukurime vezulluese, drita spektakolare, por më shumë halle.

“Festa të ngjall gëzim, por nuk është se kemi atë gëzimin që kemi pas më përpara me thënë të drejtën. Ndjehej që je në atmosferë feste por pak nostalgji për ato që ke kaluar, sa ke arritur në jetë”, shprehen të moshuarit.

Po pse vallë?! Sepse kishim zemrat plot me fëmijët pranë, - të kthejnë përgjigjen si në kor prindër, gjyshe dhe gjyshër.

I kemi harruar zakonet e vjetra me sa duket të dhuratave 20 lekëshe por me vlerë të pa llogaritshme. Sot dhuratat janë të kushtueshme materialisht por pa efekt ndjesor, të bie një telefon dhe në anën tjetër një zë i panjohur të thotë: “jam posta kam një dhuratë për ju”. Nuk ka më ‘gjuhë trupi’ afeksjon.

E megjithatë kremtimet e festave ‘me’ apo ‘pa’ do t’i presim të vijnë të bardha dhe plot dritë. Me shpresën e ‘nostalgjikëve’ se në të ardhmen e afërt tryezat dhe zemrat do mbushen plot, si dikur.....!



FORCA DETARE, 99 vite lundrim nëpër histori suksesi

“Kur të shkruhet historia e lundrimit botëror, ujërat e brendshme të Shqipërisë do të japin material shumë interesant që u përket kohërave më të lashta të historisë së lundrimit...”

E rëndësishme dhe historike fuqia e këtij aseti të Ushtrisë Shqiptare, rrugëtimi i së cilës na bën krenar. Në prag të shekullimit të tij vjen e transformuar dhe me sfida të reja drejt së ardhmes.

Forca Detare është krijuar më 25 dhjetor 1925, por traditat detare të popullit tonë janë po aq të lashta sa vetë historia e tij. Këtë traditë e trashëgojmë që nga flota e famshme e mbretit Bardhyl dhe mbretëreshës Teuta, që përballuan tre luftëra me flotën romake, tek kapedanët e famshëm ulqinakë e arvanitas, tek krijuesit e flotës detare të shtetit të parë shqiptar, deri te arkitekti dhe ndërtuesi i Flotës Luftarake Detare, kundëradmiral Abdi Mati. Historia moderne e Forcës Detare daton më 25 dhjetor 1925, kur një grup marinarësh nën drejtimin e Ahmet Kapedanit valëviten flamurin shqiptar në ujërat tona territoriale. Anijet “Shqiponja” dhe “Skënderbeg” dhanë sinjalin e parë të patrullimit të Forcës Detare, në emër të ruajtjes së kufirit detar të shtetit shqiptar.

Lufta e Dytë Botërore shkatërroi plotësisht Flotën Detare. Pas çlirimit të vendit, më 15 gusht 1945, u krijua Flota Luftarake Detare. Vitet 50 zhvilluan një etapë të re për zhvillimin e FD-së, e cila u pajis me katera silurues, dragamina, gjuajtës detar, anije ndihmuese e më pas edhe me 4 nëndetëse, ku u pajis me mjetet më moderne të kohës nga ish-Bashkimi Sovjetik dhe më vonë me mjete nga Kina.

Misioni, detyrat dhe struktura organizative e saj

Forca Detare në varësi të kohës ka pasur detyra të ndryshme, por ajo që nuk ka ndryshuar asnjëherë është misioni, i cili ka qenë dhe është aktual dhe sot. Përveç misionit tradicional të pandryshuar të Forcës Detare “Sigurimi dhe ruajtja e sovranitetit të hapësirës detare të Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me strukturat e tjera të Forcave të Armatosura”, me nevojat që kishte vendi ynë në periudhën pas viteve 90, në vitin 2002 i është shtuar edhe misioni dhe detyrat e Rojës Bregdetare. Misioni aktual është: “Sigurimi dhe ruajtja e sovranitetit të hapësirës detare të Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me strukturat e tjera të Forcave të Armatosura, zbatim i ushtrimit të ligjshmërisë në det në bashkëveprim me institucionet shtetërore me interesa në hapësirën detare”.

Detyrat Kryesore të Forcës Detare janë: Të sigurojë në çdo kohë, aftësi operacionale dhe gatishmëri luftarake, me kapacitetet e nevojshme për t’iu përgjigjur kërcënimeve dhe rreziqeve në realizimin e misionit kushtetues; Të sigurojë dhe të mbrojë hapësirën detare territoriale dhe bregdetin shqiptar, duke kryer operacione të përbashkëta me strukturat e FA-së dhe të NATO-s në



Komandanti i Forcës Detare,
kundëradmiral Adnand Agastra

drejtimet e kërcënuara; Monitorimi dhe kontrolli i trafikut detar në ujërat territoriale dhe vijën bregdetare të Republikës së Shqipërisë; Organizimi dhe realizimi i operacioneve të kërkim-shpëtimit (SAR) dhe operacioneve humanitare në ndihmë të popullsisë në bashkëpunim me strukturat e FA; Të ruajë dhe të mbrojë mjedisin

detar për zbatimin e ligjshmërisë në det; Sigurimi i kushteve hidrolundimore dhe sinjalistikës detare për një lundrim të parrezikshëm në hapësirën detare të RSH; Të ruajë dhe mbrojë mjedisin detar nga ndotjet dhe të ushtrojë kontrollin e kalimit të paligjshëm të mallrave dhe njerëzve; Të marrë pjesë në përballimin e rreziqeve asimetrike të terrorizmit, krimit të organizuar në bashkëveprim me organizmat shtetërore të specializuara në këtë drejtim. Forca Detare (FD) përbëhet nga Komanda dhe Shtabi i FD, Kompania e Mbështetjes së Shtabit, Flotilja Detare, e cila është reparti kryesor, Qendra e Vëzhgimit Detar, Shërbimi Hidrografik, Qendra e Zhytjes dhe Qendra Stërvitore Bazë Detare.

Çfarë ofron arsimimi dhe stërvitja në Forcën Detare?

Arsimimi ushtarak për detarët është pjesë integrale e arsimimit të lartë të ushtarakëve të Republikës së Shqipërisë në Akademinë e Forcave të Armatosura. Rritja e profesionalizmit, ndërveprimi dhe operacionaliteti të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH), vijimi i transformimit, modernizimit, përmbytja e angazhimeve në kuadër të Aleancës, rritja e gatishmërisë dhe zhvillimi i kapaciteteve për garantimin e sigurisë dhe përballimin e të gjithë skenarëve të kërcënimeve kërkon një qasje të re në zhvillimin dhe konsolidimin e sistemit arsimor dhe një trajnim individual të personelit për ta bërë atë sa më cilësor dhe fleksibël. Aktualisht nuk ka një Akademi Detarie, e cila për shkak të nevojave të reduktuara për personel nuk ishte e nevojshme

për të mbajtur një Akademi Ushtarake Detare.

Përveç rekrutimit të oficerëve nga akademitë detare të vendeve të tjera, rekrutohen edhe oficerë nga Akademia e Forcave të Armatosura dhe degët e navigacionit të universiteteve tona.

Qendra Stërvitore Bazë e Forcës Detare merret me trajnimin



FORCA DETARE ËSHTË KRIJUAR MË 25 DHJETOR 1925, POR TRADITAT DETARE TË POPULLIT TONË JANË PO AQ TË LASHTA SA VETË HISTORIA E TIJ. KËTË TRADITË E TRASHËGOJMË QË NGA FLOTA E FAMSHME E MBRETIT BARDHYL DHE MBRETËRESHËS TEUTA, QË PËRBALLUAN TRE LUFTËRA ME FLOTËN ROMAKE, TEK KAPEDANËT E FAMSHËM ULQINAKË E ARVANITAS, TEK KRIJUESIT E FLOTËS DETARE TË SHTETIT TË PARË SHQIPTAR, DERI TE ARKITEKTI DHE NDËRTUESI I FLOTËS LUFTARAKE DETARE, KUNDËRADMIRAL ABDI MATI. HISTORIA MODERNE E FORCËS DETARE DATON MË 25 DHJETOR 1925, KUR NJË GRUP MARINARËSH NËN DREJTIMIN E AHMET KAPEDANIT VALËVITËN FLAMURIN SHQIPTAR NË UJËRAT TONA TERRITORIALE. ANIJET “SHQIPONJA” DHE “SKËNDERBEG” DHANË SINJALIN E PARË TË PATRULLIMIT TË FORCËS DETARE, NË EMËR TË RUAJTJES SË KUFIRIT DETAR TË SHTETIT SHQIPTAR.

në specialitetet përkatëse të personelit nga detar, nënoficer, dhe oficerë sipas kriterëve funksionale. Gjithashtu Qendra Stërvitore Bazë kryen dhe trajnime për institucione të tjera të RSH si Policia Kufitare.

Procesi i arsimimit të personelit të FD-së është një sistem i konsoliduar në përputhje me standardet e NATO-s, ku ka si objekti kryesor përmbushjen e të gjithë spektrit të detyrave operacionale si dhe një sistem i unifikuar dhe standardizuar në përputhje me nevojat dhe detyrimet që shtrohen përpara një force anëtare të NATO-s.

Programet arsimore dhe stërvitore

Forca Detare si strukturë përgjegjëse për përgatitjen në specialitetet detare të personelit të saj ka Qendrën Stërvitore, në të cilën zhvillohen programet arsimore të specialiteteve detari, të cilat janë pjesë e vijimësisë së kurrikulave të Akademisë së FA-së, të akredituara nga Ministria e Arsimit. Disa prej kurseve funksionale që ofrohen nga kjo strukturë janë: Kursi Bazë i Oficerit të Marinës, Kursi në specialitetin “Bocman-Sinjalist”, Kursi në specialitetin “Motorist-elektricitist dhe jetëgjatësia në anije”, Kursi “SAR & Bording”, Kursi në specialitetin “Sistemet e armatimit në anije”, Kursi në specialitetin e ligjshmërisë detare, etj.

Në bashkëpunim me Qendrën e Zhytjeve, Qendra Stërvitore Bazë organizon edhe Kursin Bazë të Zhytjes, i cili është një kurs në nivel kombëtar ku përgatiten dhe forcat Speciale të FARSH dhe RENEA e Policisë së Shtetit.

Çfarë synohet të arrihet mes tyre?

Me zhvillimin e këtyre kurseve, trajnimeve dhe stërvitjeve mundësohet përgatitja e personelit të FD-së në aftësimin profesional dhe fizik në interes të realizimit të misionit dhe detyrave.

Stërvitjet më të rëndësishme të FD-së

Në aktivitetin e saj kryesisht pas viteve 90, FD ka zhvilluar si dhe ka marrë pjesë në shumë stërvitje bilaterale si dhe multilaterale në kuadër të Aleancës si dhe në atë rajonal. Një stërvitje me pjesëmarrjen e disa shteteve anëtare të NATO-s ishte ajo e vitit 2005 COOPERATIVE ENGAGEMENT, ku FD kishte rolin bashkë-drejtuës si dhe stërvitja u zhvillua në ujërat territoriale të Republikës së Shqipërisë. FD është aktive në iniciativën ADRION, e cila që prej vitit 2006 vazhdon stërvitjet praktike LIVEX, stërvitje që zhvillohet me rotacion ku çdo vit vendi organizator është njëri nga shtetet anëtare të Iniciativës. Që nga viti i anëtarësimit në Iniciativën ADRION, vendi ynë ka qene 3 herë vendi organizator i kësaj stërvitjeje. Përtej tyre në mënyrë të vazhdueshme FD ka zhvilluar stërvitje si në ujërat tona territoriale por dhe në ujëra ndërkombëtare, stërvitje me vende si SHBA, Angli, Francë, Itali etj. Këto stërvitje kanë bërë të mundur që efektivat jo vetëm të aftësohen dhe të ngrihen profesionalisht, por dhe të ndërveprojnë me anijet e NATO-s me detyrat dhe nevojat, qofshin ato kombëtare apo nevoja rajonale si dhe të NATO-s. Është e njohur nga të gjithë stërvitja e NATO-s “DEFENDER EUROPE 2022”, e cila pat një përfshirje nga të gjithë FARSH, ku FD kishte rolin kryesor në sigurimin dhe mbështetjen në stërvitjen. Një stërvitje shumë e veçantë është stërvitja bilaterale, e cila u zhvillua me SHBA-të me anijet e Flotës së 6 të Paqësorit, ku për herë të parë FD zhvilloi qitje me anijet amerikane GUNEX. Të gjitha këto stërvitje bëjnë të mundur aftësimin e efektivave si dhe mundësinë e tyre që të ndërveprojnë me vendet e Aleancës, pasi stërvitjet zhvillohen sipas procedurave standarde të standardizuara nga vendet aleate të NATO-s. Gjithashtu Forca Detare periodikisht merr pjesë me personel ose dhe me anije në stërvitjet ndërkombëtare që zhvillohen

nga NATO në vende të ndryshme të rajonit. Si të tilla mund të përmenden pjesëmarrja në stërvitjet “Mare Aperto” në Itali, “NIIRIS” në Greqi, “BREEZE” në Bullgari dhe “SEA SHIELD” në Rumani, etj..

Disa prej arritjeve të 10-vjeçarit të fundit të Forcave Detare

FD/Roja Bregdetare është një kapacitet aktiv i FARSH-së me angazhimin e saj 24/7. Për shkak të kësaj domosdoshmërie FD stërvitet, trajnohet, por dhe modernizohet si rezultat i së cilës është edhe pajisja me 4 anijet të reja të Klasit “Iliria”, një prej të cilave u ndërtua nga Kompania “DAMEN Shipyards” në Holandë ndërsa 3 të tjerat u ndërtuan në Kantierin e Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve në Pashaliman, Vlorë. Gjithashtu ngritja e Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare (SIVHD) të RSH me kompaninë amerikane “Lockhead Martin” siguron kapacitete vëzhguese dhe monitoruese të hapësirës detare, duke u ofruar këtë shërbim edhe Institucioneve të tjera me interesa në det.

Bashkëpunimi me institucionet e tjera ligj zbatuese ka sjellë uljen e aktiviteteve të jashtëligjshme si dhe garantimin e ujërave tona për një lundrim të sigurt. Si një nga arritjet e Forcës Detare në këtë 10-vjeçar mund të përmendim pjesëmarrjen për tre vjet rresht me anije dhe personel në Aktivitetin e NATO-s ne Detin Egje, pjesë e operacionit të NATO-s “Sea Guardian”, ku detyra kryesore ishte kontrolli dhe ndalimi i emigracionit të paligjshëm që vinte si rezultat i luftës në Siri si dhe shpëtimi i emigrantëve që u rrezikohej jeta në det. Gjatë pjesëmarrjes në këtë operacion anijet e Forcës Detare asistuan dhe morën pjesë në shpëtimin e rreth 3000 emigrantëve të paligjshëm që u rrezikohej jeta në det. Forca Detare mori pjesë për herë të parë në një operacion të drejtuar nga NATO, i cili për herë të parë në FA u mbështet plotësisht nga Forca Detare. Pjesëmarrja në këtë operacion të Forcës Detare u vlerësua maksimalisht nga NATO dhe pavarësisht faktit të sasisë së limituar të kapaciteteve të vendit tonë, përsëri u arrit angazhimi me efikasitet në përballimin e kësaj detyre. Ky lloj angazhimi kërkonte jo vetëm pajisje dhe teknike, por edhe një trajnim dhe stërvitje të mirë të personelit për të përballuar vështirësitë që sjellin kushtet atmosferike dhe deti. Ky angazhim u arrit edhe në sajë të besimit që kishte Ministria e Mbrojtjes, SHPFA dhe vetë Forca Detare në personelin e saj se ky angazhim do të përmbushej me sukses.

Ambicia e Forcës Detare vijon të rritet mbi bazën e vlerësimit të mundësive tekniko-financiare, por dhe mbi besueshmërinë që kemi në përgatitjen e efektivave. Këtë vit Forca Detare ka deklaruar pjesëmarrjen në dy operacione të NATO-s për vitin 2023: Rikthehemi në Aktivitetin e NATO-s në Detin Egje si dhe për herë të parë do të marrim pjesë në operacionin e NATO-s, FOCOPS që ka të bëjë me grumbullimin, analizimin dhe shkëmbimin e informacionit gjatë patrullimit në hapësirën e caktuar detare për sigurinë detare të Aleancës. Duhet theksuar se viti 2022 ka qenë një sukses, jo vetëm për Forcën Detare por edhe për shtetin Shqiptar, pasi gjatë këtij viti u anëtarësua në dy organizata ndërkombëtare IHO (Organizata ndërkombëtare e Hidrografisë) dhe IALA (Shoqata Ndërkombëtare e Sigurisë së Lundrimit Detar dhe Fenerëve). Kjo arritje do të përmirësojë sigurinë hidro-lundrimore si dhe mundëson krijimin e standardeve ndërkombëtare në hapësirën tonë detare me qëllim lundrimin sa më të sigurt në këtë hapësirë. Projektet më të rëndësishme në drejtim të modernizimit të sistemit të integruar të vëzhgimit të hapësirës detare, dhe infrastrukturës së reparteve të FD-së

Nga pikëpamja e ambicies që Forca Detare ka në vijim për rritjen e kapaciteteve, duke filluar nga viti 2023, projektet më të rëndësishme do të jenë: Kompletimi me një anije patrulluese me kapacitete të mirëfillta luftarake për luftën detare dhe kundërajrore. Për këtë projekt madhor ka filluar puna për hartimin e kërkesave operacionale dhe planifikimin e fondeve të nevojshme për zhvillimin me sukses të këtij projekti. Një projekt tjetër i rëndësishëm është modernizimi i Qendrës së Zhytjes me kapacitete dhe pajisje të afta për skanimin e tabanit të detit me qëllim zbulimin dhe identifikimin e minave detare apo municioneve të mbetura. Gjithashtu projekt i rëndësishëm është edhe modernizimi i Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare (SIVHD), ku Forca Detare dhe NATO kanë koordinuar për specifikimet teknike të kërkesës operacionale për këtë sistem. Përveç këtyre projekteve madhore të cilat priten të përfundojnë në një periudhë afatshkurtër, në vëmendje janë edhe disa projekte të tjera, të cilat përmirësojnë dhe rrisin kapacitetet e Forcës Detare. Si të tilla mund të përmendim kompletimin me 6 anije të reja patrulluese të mesme, të cilat do të zëvendësojnë disa nga anijet e vjetra që kanë përmbushur kohën e përdorimit. Në planin afatgjatë një projekt tjetër është edhe kompletimi me një anije shumë-funksionale për Qendrën e Zhytjeve dhe Shërbimin Hidrografik.



Komanda Mbështetëse, misioni vazhdon...

Komanda Mbështetëse si një prej strukturave më të rëndësishme të Forcave të Armatosura kremton në formatin e saj të ri prej vitit 2007, 17 vite përkushtim, mbështetje, menaxhim, administrim, angazhim në misione brenda dhe jashtë vendit.

Kontributi i saj është mjaft i rëndësishëm dhe në ndihmën ndaj popullsisë civile. Në përmirësimin e infrastrukturës me vendosjen e urave 'Baily' në zonat ku ka qenë i pamundur komunikimi nga një fshat në tjetrin, në shuarjen e zjarreve, në situata përmbytjesh, në demontime lëndësh plasëse.

Në vitin 2007, Brigada e Furnizimit riorganizohet në Komandë Mbështetëse, por historiku i saj daton prej 14 nëntorit 1947, me krijimin e Depos Qendrore të Intendencës, në vitin 1948, Depoja Qendrore e Intendencës emërtohet Magazinat Qendrore të Ushtrisë, në vitin 1949, Magazinat Qendrore të Ushtrisë emërtohen me numër reparti 8770, në vitin 1993, Magazinat Qendrore të Ushtrisë, emërtohen Bazat e Furnizimit të Ushtrisë në Tiranë, Elbasan, Berat dhe Rrëshen, në vitin 2000, krijohet Komanda e Mbështetjes Logjistike. Në vitin 2003, në kuadër të riorganizimit të Komandës së Mbështetjes Logjistike, krijohet Brigada e Furnizimit, në vitin 2010, Komanda Mbështetëse suprimohet dhe riorganizohet Brigada Logjistike, në vitin 2014, Brigada Logjistike riorganizohet dhe riemërtohet Komandë Mbështetëse, në vitin 2017, KM me po të njëjtën strukturë riorganizohet duke u suprimuar batalioni i municionit, aktiviteti i të cilit u thith nga batalioni i furnizimit, si dhe riorganizimi i batalioni të xhenios.

Në vitin 2018, KM me po të njëjtën strukturë riorganizohet Qendra Stërvitore, në 2022, KM riorganizohet duke iu hequr nga struktura e Laboratorit Qendror të FA-së, në vitin 2023, KM riorganizohet, kalimi i DMR Kukës, Burrel, Korçë, Gjirokastrë, dhe Detashmenti CIMIC tek Forca Tokësore dhe riorganizimi i BMEC.

Misioni i Komandës Mbështetëse është: Mbështetje me shërbime të trupave të luftimit, mbështetjes së luftimit të Komandave në kohë paqe/krize/luftime, në interes të plotësimit të misionit të tyre, si dhe në operacione të Emergjencave Civile dhe në misionet ndërkombëtare.

Detyrat e Komandës Mbështetëse janë: Të sigurojë në çdo kohë aftësi operacionale dhe gatishmëri luftarake në kapacitetet e nevojshme, për t'iu përgjigjur kërcënimeve dhe rreziqeve në realizimin e misionit kushtetues.

Të mbështesë aktivitetet e Forcave të Armatosura të RSH me të gjitha klasat e furnizimit (1-5) dhe me shërbime logjistike. Të sigurojë kapacitete të nevojshme operacionale për kryerjen e operacioneve luftarake, emergjencave civile, kërkim-shpëtim, operacioneve humanitare dhe ato në ndihmë të komunitetit në bashkëpunim me strukturat e tjera të FA-së.

Të sigurojë kapacitete të nevojshme operacionale për përmirësimin e infrastrukturës së FA-së të RSH. Të sigurojë kapacitete të nevojshme operacionale për kërkimin, zbulimin, çminimin dhe asgjësimin e municioneve të rrezikshme dhe lëndëve plasëse në operacionet brenda dhe jashtë vendit. Të sigurojë mbështetjen e strukturave të FA-së me riparime, mirëmbajtje të përgjithshme të specializuara të mjeteve motorike tokësore, në operacione brenda dhe jashtë vendit në kohë paqe, krize, luftime e



emergjencave civile; Të mbështesë me transport strukturat e FA-së brenda dhe jashtë vendit; Të sigurojë mbështetjen shëndetësore të personelit ushtarak aktiv në rezervë dhe pension, familjeve të tyre si dhe punonjësve civil të FA-së; Të administrojë, menaxhojë municionet, armatimin, teknikën dhe pajisjet rezervë të FA-së të RSH; Të ruajë, administrojë materialet, vlerat monetare, pajisjet në përdorim e rezervë, sipas klasave dhe niveleve të furnizimit; Të

sigurojë nëpërmjet BCU-së, trajnimin dhe përgatitjen e personelit ushtarak dhe civil për detyra specifike që dërgohen me misione jashtë vendit. Të arsimojë, trajnojë, stërvitë, të kualifikojë oficerët, nënoficerët dhe ushtarët e strukturave të FA-së në specialitetin furnizim, transport, mirëmbajtje, xhenio, personel-administratë, armatim-municion dhe shëndetësi në interes të përmbytjes së misionit të tyre.



Ministrat e Mbrojtjes aleate miratuan Qasjen e NATO-s për Kundër Kërcënimeve të Informacionit. Kjo do të forcojë Aleancën duke krijuar një qasje të lidhur mirë dhe të ndërveprueshme për të identifikuar, parandaluar dhe për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive kërcënimeve të informacionit. Aleanca vazhdon të përballlet me kërcënime hibride në rritje nga aktorët shtetërorë dhe jo shtetërorë, të cilët shpesh synojnë vlerat tona dhe minojnë sigurinë tonë, jo më pak përmes manipulimit të mjedisit të informacionit.

Qasja e NATO-s fokusohet në kërcënimet e informacionit: aktivitete të qëllimshme, të dëmshme, manipuluese dhe të koordinuara, të cilat në mënyrë rutinore përfshijnë manipulimin dhe ndërhyrjen e informacionit nga aktorët e huaj dhe operacionet e informacionit. Këto aktivitete përdoren për të krijuar konfuzion, për të mbjellë ndarje, për të destabilizuar shoqëritë, për të ndikuar në perceptimet dhe sjelljet, dhe në fund të kenë një ndikim negativ në NATO, aleatët dhe partnerët.

Edhe pse kërcënimet e informacionit nuk janë një rrezik i ri për Aleancën, sfidat e reja janë në rritje. Në dritën e teknologjive me zhvillim të shpejtë, veçanërisht në fushën e inteligjencës artificiale (AI), shkalla dhe sofistikimi i taktikave, teknikave dhe procedurave kanë arritur nivele të paprecedentë, duke përforcuar ndjeshëm përdorimin dhe ndikimin e tyre.

Nëpërmjet kësaj qasjeje të përbashkët, NATO forcon më tej aftësinë e saj për të kuptuar, parandaluar, përmbajtur dhe zbutur dhe rikuperuar nga kërcënimet e informacionit, dhe përforcon angazhimin e saj për ta bërë këtë në respekt të plotë të të drejtave themelore, duke përfshirë lirinë e shprehjes.

Qasja e NATO-s kundër kërcënimeve të informacionit

Aktorët keqdashës kryejnë në mënyrë rutinore operacione informacioni armiqësore kundër NATO-s, vendeve anëtare dhe partnerëve të saj. Kërcënimet e informacionit janë aktivitete të qëllimshme, të dëmshme, manipuluese dhe të koordinuara – duke përfshirë manipulimin dhe ndërhyrjen e informacionit nga aktorët e huaj dhe dezinformimin e përhapur përmes mediave tradicionale dhe sociale – të krijuara për të krijuar konfuzion, thellimin e ndarjeve, destabilizimin e shoqërive dhe përfundimisht dobësimin e Aleancës. NATO punon ngushtë me aleatët dhe partnerët për të kuptuar, kundërshtuar dhe ndërtuar qëndrueshmëri ndaj këtyre kërcënimeve të informacionit.

Cilat janë kërcënimet e informacionit?

Kërcënimet e informacionit janë aktivitete të qëllimshme, të dëmshme, manipuluese dhe të koordinuara, të kryera nga aktorë shtetërorë dhe jo shtetërorë për të dobësuar dhe përçarë NATO-n, anëtarët e saj dhe partnerët e saj. Këto aktivitete informative armiqësore mund të përfshijnë shumë TTP të ndryshme të krijuara për të manipuluar opinionin publik.

Prandaj, keqinformimi është i përjashtuar nga përkufizimi i kërcënimeve të informacionit. Ky fenomen përshkruan informacion të rremë ose të pasaktë të përhapur pa qëllime keqdashëse. Megjithatë, efektet e dezinformatave mund të jenë ende të dëmshme, duke i bërë komunikimet proaktive dhe aksesin e lehtë në fakte edhe më të rëndësishme.

Pse kërcënimet e informacionit janë kaq të rrezikshme?

Kërcënimet e informacionit mund të përbëjnë një kërcënim për sigurinë kombëtare. Konkurrentët strategjikë po kërkojnë vazhdimisht të shfrytëzojnë hapjen, ndërlidhjen dhe dixhitalizimin e vendeve tona. Ata ndërhyjnë në proceset dhe institucionet tona demokratike, sfidojnë vlerat tona dhe synojnë sigurinë e qytetarëve tanë përmes taktikave hibride, si drejtpërdrejt ashtu edhe përmes prokurave. Ata gjithashtu shfrytëzojnë narrativat gjinore dhe promovojnë kërcënime informacioni me temë gjinore për të mbjellë ndarje dhe destabilizuar shoqëritë. Kjo sfidon sigurinë, qëndrueshmërinë, interesat, vlerat dhe mënyrën demokratike të jetës së Aleancës, duke përfshirë të drejtat themelore si liria e shprehjes.

Kërcënimet e informacionit, të tilla si dezinformimi, grisin strukturën që i mban shoqëritë të bashkuara. Ato minojnë besimin e njerëzve te qeveritë dhe institucionet e tjera publike. Ato zakonisht janë të dizajnuara për të apeluar ndaj impulseve, frikës dhe paragjykimëve më të këqija të njerëzve - vënia e fqinjit kundër fqinjit, helmimi i grupeve shoqërore kundër njëri-tjetrit, vërtetimi dhe ndezja e ekstremizmit, degradimi i ndjenjave të njerëzve për përkatësi në një komunitet ose një vend - të gjitha në një përpjekje për të përçarë dhe të pushtojnë një shoqëri në fushën e betejës së informacionit.

Zhvillimet e shpejta teknologjike, veçanërisht në fushën e inteligjencës artificiale dhe falsifikimeve të thella, kanë potencialin të minojnë më tej besimin e publikut në komunikim duke përforcuar operacionet e informacionit armiqësor, duke krijuar konfuzion në mjedisin e informacionit dhe duke ndryshuar perceptimet në mënyra delikate, por domethënëse.

Kërcënimet e informacionit nuk janë krijuar gjithmonë për t'i bindur njerëzit të besojnë një tregim armiqësor ose një gënjeshtër specifike. Ndonjëherë ato janë krijuar për të ngatërruar dhe për të turbulluar ujërat me informacione kontradiktore, në mënyrë që të pengojnë njerëzit të bëjnë dallimin midis faktit dhe trillimit. Disa njerëz do të preken nga informacioni keqdashës dhe do ta ndihmojnë

Aleatët e NATO-s, qasje të përbashkët për të luftuar kërcënimet e informacionit



atë të përhapet. Të tjerët do të zhgënjehen nga vërshimi i gënjeshtërave dhe do të shkëputen plotësisht. Të dyja këto rezultate mund të jenë të dobishme për aktorët armiqësorë që kërkojnë të degradojnë qëndrueshmërinë e një shoqërie.

Në fund të fundit, kërcënimet e informacionit janë në gjendje të provokojnë dëme në botën reale. Prandaj, mbrojtja e 1 miliard qytetarëve nga këto kërcënime është një prioritet i sigurisë kombëtare në NATO, aleatët dhe partnerët e NATO-s kanë një rol thelbësor për të luajtur për të luftuar kërcënimet e informacionit përmes një qasjeje të gjithë shoqërisë.

Pse NATO kujdeset për kërcënimet e informacionit?

Suksesi i NATO-s si një aleancë e mbrojtjes kolektive varet nga fuqia dhe vendosmëria e vendeve anëtare të saj. Çdo manipulim informacioni dhe ndërhyrje nga aktorë të huaj që përpiqet të dobësojë shoqëritë aleate – dhe në këtë mënyrë të degradojë aftësinë e NATO-s për të mbrojtur anëtarët e saj është si rrjedhim me interes për NATO-n.

Për më tepër, si një aleancë e vendeve demokratike, NATO e merr legjitimitetin e saj nga besimi dhe mbështetja e vazhdueshme e qytetarëve aleatë. Kjo është arsyeja pse NATO vetë-përballlet me kërcënime informacioni nga aktorë keqdashës, ata kërkojnë të pakësojnë besimin e publikut dhe të minojnë solidaritetin e Organizatës. Këta aktorë përdorin një gamë të gjerë narrativash armiqësore kundër NATO-s (shih Rregullimi i të dhënave për disa shembuj specifikë).

Si i kundërshton NATO kërcënimet e informacionit?

Koordinimi me aleatët dhe partnerët

Qasja e NATO-s për të luftuar kërcënimet e informacionit mbështetet në bashkëpunimin e ngushtë me aleatët dhe partnerët. Para së gjithash, NATO punon me qeveritë kombëtare aleate për

të kundërshtuar kërcënimet e informacionit. Aleanca gjithashtu bashkëpunon me qeveritë e vendeve të saj partnere dhe organizata të tjera ndërkombëtare, si Bashkimi Evropian, Mekanizmi i Reagimit të Shpejtë G7, Kombet e Bashkuara dhe Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD). NATO gjithashtu lidhet me kompani private, organizata mediatike, platforma të mediave sociale, organizata të shoqërisë civile dhe institucione akademike për të mësuar më shumë rreth kërcënimeve të informacionit dhe për të zhvilluar strategji për të zbutur efektet e tij.

Bashkëpunimi me të gjitha palët e interesuara i ndihmon të gjitha palët të krijojnë një pamje gjithëpërfshirëse të kërcënimeve aktuale të informacionit. Çdo palë e interesuar mund të ndërtojë njohuritë e të tjerëve, duke identifikuar aktorët keqdashës dhe narrativat armiqësore më shpejt, dhe duke iu përgjigjur kërcënimeve të informacionit në një mënyrë më të shkathët dhe të koordinuar. Të gjithë aktorët në mjedisin e informacionit – nga organizatat e mëdha si NATO-ja tek njerëzit individualë në vendet anëtare dhe partnere – kanë një rol për të luajtur në përballjen me kërcënimet e informacionit.

Opsionet e reagimit të NATO-s

Duke u mbështetur në këtë qasje bashkëpunuese, përgjigjet ndaj kërcënimeve të informacionit përfshijnë opsione reagimi afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, duke përfshirë masat proaktive. Këto opsione sigurojnë fleksibilitet dhe aftësi për të rritur ose ulur në varësi të kërcënimit dhe mbështesin objektivat dhe prioritetet e komunikimit strategjik të NATO-s. Përgjigjet bazohen në katër funksione kryesore: Kuptimi i mjedisit të informacionit; Parandalimi i efektivitetit të kërcënimeve të informacionit; Përmban dhe zbut kërcënimet e informacionit; Rikuperimi i shpejtë duke nxjerrë mësim nga kërcënimet e informacionit.





Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Në këtë trajtesë të shkurtër po shkruaj disa mendime në lidhje me përshkrimin që iu ka bërë Edith Durham luftëtarëve shqiptarë në shkrimet dhe librat e saj të botuar. Prej gjithë udhëtarëve britanikë që erdhën ose kaluan në Shqipëri, Mary Edith Durham është edhe sot padyshim më e spikatura dhe mbetet më e lidhura me Shqipërinë, shqiptarët dhe çështjen e tyre. Ndërsa vizitorë të tjerë të huaj që kaluan nëpër Shqipëri e përshkruan atë së bashku me vendet e tjera ballkanike, kurse Durhami gjithnjë e më tepër u mor me problemet shqiptare, duke bërë përshkrime edhe për luftëtarët shqiptarë, armatimet dhe veshjet e tyre.

Edith Durham jo vetëm admiroi trimërinë, atdhedashurinë dhe bujarinë e shqiptarëve, por ajo u interesua me devotshmëri për fatin tragjik të Shqipërisë dhe popullit shqiptar, që po kërcënohej në ato vite nga synimet dhe pazaret e shumta të Fuqive të Mëdha, që vinin në pikëpyetje ekzistencën e tij si komb. Me veprimtarinë e saj si publiciste, gazetares, autore librash, piktore, ajo u bë në opinionin përparimtar e politik të kohës përkrahëse aktive e çështjes së lirisë së Shqipërisë dhe të luftës së shqiptarëve për liri dhe një nga vëzhguesit e huaj me perceptimin më të mirë të ngjarjeve.

Fan Noli do të shkruante për të: “Zonja e nderuar Angleze nuk ditka të tregojë vetëm simpatinë e saj për racën shqiptare, vetëm me libra të bukur. Puna që bëri në Podgoricë për refugjatët e urtë dhe kryengritësit e plagosur është aq fisnike, aq e lartë, aq e disinteresuar sa meriton mirënjohjen e gjithë kombit”.

Në përshkrimin e saj për luftëtarët e veriut dhe të jugut të Shqipërisë ka theksuar se tek këta ekziston “konservimi i ca vlerave humane”, “vërsuleshin teposhtë me guxim rebelësh” dhe “se kishin për gjë të mos i bindeshin as mbretit të tyre, kur nuk ua donte qejfi”. Këto vlera humane të shfaqura prej shqiptarëve në të gjitha takimet e saj në Shqipëri, ajo i quan një sekret të tyre. Në analizën e tyre ajo mundohet të zbërthejë disa detaje që tek këta njerëz shfaqin vlera luftarake të admirueshme.

Përshkrimin e saj për luftëtarët shqiptarë e nis që nga historia e lashtë, nga periudha romake e për të ardhur deri në fillimet e shek. XX, kur ajo i pa me sytë e saj luftëtarët shqiptarë nga veriut në jug. Ajo i quan “luftëtarë të rreptë dhe piratë të regjur”, sepse nuk kishin vetëm aftësi fizike por edhe mendore. Kur flasim për luftëtarë të rreptë në ushtri ne kuptojmë një përgatitje të gjithanshme luftarake, zotërim të artit të luftimit, zbatim të rregullave të betejës, përdorim me mjeshhtëri të shigjetës, shpatës dhe perfeksionim në përdorimin e armëve të zjarrit. Ajo arrin në përfundime se shqiptarët kanë qenë një popullsi e dendur në çdo kohë, sepse gjithmonë pushtuesve iu është dashur shumë kohë për të pushtuar vendin, që nga koha e Ilirisë, Arbërisë dhe deri në luftërat botërore të zhvilluara. Më tej vazhdon se ata janë “piratë të regjur”, që e njohin dhe e zotërojnë detin dhe fuqinë e tij. Kjo na tregon se dhe flota ushtarake e kohës ka qenë më e lehte, më e shpejtë dhe gjithmonë ka vepruar me një taktikë dhe mjeshhtëri si përgatitja e veçantë e piratëve të detit.

Ajo na tregon se mbi luftëtarët shqiptarë janë sulur ekspedita ndëshkimore të pushtuesve të ardhur në tokën e Ilirisë, por pushtuesit kanë hasur në një popullsi trime dhe kanë bërë një luftë të gjatë. Kështu ka ndodhur që me pushtimin romak, me osmanët, me fashistët dhe me nazistët etj. Në të gjitha udhëtimet e bëra në Shqipëri ajo flet për malet e saj, këta aleatë të përhershëm të shqiptarëve, të cilët i kanë mbrojtur dhe janë bërë njësh me luftëtarët. Malet e Shqipërisë, i vlerëson si strehim të luftëtarëve dhe mburojë e tyre. Malet i kalitnin dhe i stërvitnin luftëtarët duke arritur në përfundim se ajo e “kuptoi me shpejtësi shpirtin e shqiptarëve” dhe se fiset e malësisë së Shqipërisë, luftonin për t’u mbrojtur. Ajo si një studiuese e vëmendshme është futur në thellësi të gjërave të vogla tek çdo shqiptar të takuar, kudo ku shkeli këmba e kësaj malësoreje nga Anglia.

Ajo do të përsëriste shpesh se “kudo ku kam shkuar kam gjetur një kod moral në jetën e tyre që është ‘konak dhe besë’”. Në çdo konak, sipas traditës shqiptare, ka gjetur bujarinë dhe besnikërinë



Luftëtarët e Shqipërisë në optikën e Edith Durham



“ZONJA E NDERUAR ANGLEZE NUK DITKA TË TREGOJË VETËM SIMPATINË E SAJ PËR RACËN SHQIPTARE, VETËM ME LIBRA TË BUKUR. PUNA QË BËRI NË PODGORICË PËR REFUGJATËT E URTË DHE KRYENGRITËSIT E PLAGOSUR ËSHTË AQ FISNIKE, AQ E LARTË, AQ E DISINTERESUAR SA MERITON MIRËNJOHJEN E GJITHË KOMBIT”.



shqiptare. Me shumë kujdes jep detaje për mënyrën e pritjes së shqiptarëve, për mënyrën e dorëzimit të armës tek i zoti i shtëpisë, vendosjen e tyre në vend të sigurt, qëndrimin në besë të çdo shqiptari, që ishte një kod dhe një dukuri e tyre e veçantë.

Në çdo pritje shqiptarët kudo ku gjendeshin dhe takoheshin kishin një shprehje që ngulitej thellë në zemër kur të thoshin “mirë se erdhe!”. Kjo mirë se ardhje iu del drejt e nga shpirti. Është një karakteristikë dhe një vlerë që Edith e gjeti tek të gjithë shqiptarët, si një kombësi e veçantë.



Një vend të veçantë që Edith Druhami bën përshkrimin e luftëtarëve për lirinë e vendit, e njohur edhe si Tringa e Grudës (1870-1917), ku në kryengritjen e vitit 1911 mori pjesë me armë në Deçiq e gjetkë dhe ndihmoi sidomos për furnizimin me armë e ushqime dhe për tërheqjen e mjekimit e të plagosurve. “... Ata më drejtuan në shtabin e fisit të Grudës... Njerëzit e Grudës ishin vendosur në shtëpinë e madhe të një myslimani të pasur. Tringë Smajla nga Gruda, një virgjreshë shqiptare, e fortë dhe e shëndoshë, që nuk e di se ç’është frika, kishte rrëmbyer në Deçiq një kalush trugjatë e të shkurtër, ngjyrë hiri, bërë si një baldosë, e kishte ngarkuar me kafe, bukë, kripë dhe kishte ardhur për të gatuar për njerëzit e fisit të Grudës”.

Kudo ku ka shkuar, ajo thekson për traditat e malësorëve të Shqipërisë Veriore. Këto tradita shfaqeshin në ndërtimin e shtëpive, në vendosjen e tyre në pozicione që të shërbenin për t’u mbrojtur, shtëpi tip kulle me frëngji dhe të mbrojtura nga pozicioni gjeografik. Tek çdo shqiptar kam parë kujdesin për pushkën, për mirëmbajtjen e saj, për stërvitjen e të rinjve dhe për shpejtësinë me të cilën e zotëronin dhe e përdornin atë.

Me syrin e një analisteje ajo vëren kudo që shkon se si “të gjithë burrat, që lëronin tokën mbanin gjeverdare (pushkë)”. Ndërsa të gjithë “barinjtë kishin martina dhe gjerdanët plot me fishekë”. “Kudo kam parë shumë të rinj, çunakë të errët, fort të pashëm, të hedhur dhe sqimatarë, me paraqitje krenarie sikur donin të thoshin ‘vëri gishtin kokës, jam unë këtu’”. Më tej ajo jep dhe përfundimin se “jeta... është shumë e rëndë, prandaj ata më të fortët mund të mbijetojnë”.

Në një vend tjetër tregon se si suvaria, kalorësi kishte ndalur për të parë dy trungje arrash të mëdhenj, “shenjave të plumbave në qitje me pushkë që kishin pasur bërë njerëz të ndryshëm”. Pra, pushka për shqiptarin siç thotë dhe Kadare “qindra kilometra hije lëshonte mbi dhe”, ishte bërë një trup me të.

Në analizën e problemeve ajo arrin në këtë përfundim se çdo shqiptar është i “marrë që s’është i armatosur”. Lëvizja e çdo shqiptari në territor “jashtë pa qenë i armatosur... është aq budallallëk”.



Edith Druham ishte e pandarë nga luftëtarët shqiptarë. E vërteta është se shqiptarët e kanë nderuar dhe e nderojnë edhe sot Durham, pasi ajo u fali zemrën atyre, ndërsa ata mirënjohjen e thellë. Ndaj dhe studimet e saj ata i konsiderojnë si pjesë autentike dhe të pandara të historisë së tyre. Madje, ajo cilësohet e nderohet si një nga figurat më të spikatura të huaja të shekullit të kaluar që ka luftuar për pavarësinë dhe lirinë e Shqipërisë si nga autoritetet shtetërore ashtu dhe nga autoritetet dhe institucionet e larta shkencore të vendit tonë. Megjithatë, në këtë 75 vjetor të ndarjes nga jeta, ashtu si dhe protagonistët e tjerë historikë, edhe ajo, duhet të konsiderohet si një protagoniste dhe luftëtare e duhet t’i kushtohet vëmendje.

Edith Durham ishte një grua e mençur, fisnike, trime dhe kurajoze. Ajo për një jetë të tërë punoi e luftoi që vendi ynë t’i shpëtonte copëtimit e të merrte përparim dhe zhvillim. Misionin e kësaj gruaje trime dhe kurajoze një gazetë angleze dhe e botuar nga “Dielli” 1917, e përshkruan kështu: “Një udhëtim për liri ndaj përpjekjeve të grekëve për të helenizuar Korçën. Mundimi i Znj. Durham për shpëtimin e atij qyteti. Çau malet nga Korça në Berat për një telegraf në Londër”.

Në të gjitha këto udhëtime, Edith Durham shkroi studime historike, etnografike, antropologjike, të traditës, folklorit e të zakoneve tona, si dhe shkroi libra, midis të cilëve mund të përmendim “Lufta për Shkodrën”, “Origjina e disa fiseve”, “20 vjet ngatërresa Ballkanike”, “Kulti i Diellit dhe Hënës në Ballkan”, “Shqipëria e sipërme”, “Brenga e Ballkanit” etj.

Në udhëtimin e parë dhe të gjatë në Shqipëri nga Jugu në Veri në vitin 1904, i bënë përshtypje të gjitha shtresat e popullsisë, kudo ku shkoi, të gjithë kërkonin pavarësinë e atdheut. Durhami nga kjo zbuloi një zë legjitim plot pasioni sa dhe real, një e drejtë kjo që sipas saj s’mund t’ua mohonte askush... as luftëtarëve shqiptarë.

Në vitin 1908, Durhamin e tërhoqën viset e Malësisë së Veriut të Shqipërisë. Në këtë kohë ajo e kishte transformuar veten në një etnografe dhe shprehte vendosmërinë në bërjen e studimeve serioze të fiseve shqiptare në trevat e Malësisë, dhe këtë e bëri realitet duke

shkruar librin: “Shqipëria e Epërme” (1909). Ajo udhëtoi duke kaluar nga një fshat në tjetrin, e cila mori nderim madhështor. Për çdo fshat ajo evidentoi historitë dhe fotografoi nga afër çdo aspekt të jetës në fshatrat malore dhe arriti të grumbullonte një arkiv të pasur të traditave dhe zakoneve folklorike shqiptare. Gazetari britanik, Henri Nevinston, që e shoqëroi Durhamin kur ajo administronte ndihmat për malësorët shqiptarë, gjatë luftërave ballkanike të 1911-1913, duke përshkruar cilësitë që e shndërruan atë në legjendë, thekson: “Qysh kur vuri këmbën në Shqipëri, ajo u bë shqiptare me zemër dhe shpirt”. Ndaj këta “njerëz besnikë, kurajozë, e mikpritës” siç i cilëson shqiptarët ajo, duhen përkujtuar gjithmonë dhe kanë vlera shkrimet në vijimësi për Edith Durham. Kështu zbatohet dhe një porosi e Nolit: “... T’u ipet rrasja të gjithë atdhetarëve të këtushëm t’i tregojnë botërisht shtimin dhe mirënjohjen e tyre”.

“PERA PALAS” I STAMBOLLIT, NGA NISI RRUGËTIMI I PAVARËSISË SË SHTETIT SHQIPTAR



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Stambolli 2692 vjeçar, i shquar në historinë e botës

Stambolli (Istanbul) është qytet i gjurmëve të thella historike, muzeve, kulturës, civilizimit, arsimimit, pasurisë, turizmit, tregtisë, transportit tokësor, detar e ajror, qytet i zhurmshëm me jetë e gjallëri plot ngjyra, një qytet përherë i zgjuar. Në Stamboll gjenden rrënjët aristokratike të tre perandorive, Romake (Roma e Lindjes/Roma e re), Bizantine dhe Osmane. Stambolli është në fakt qendra kryesore kulturore, ekonomike dhe industriale, është i vetmi qytet në botë që gjendet në dy kontinente dhe i ndarë në tre zona kryesore Stambolli i vjetër (Emininy dhe Fatih, Bejollu pranë Gallatës që të dyja në pjesën e Stambollit evropian si dhe Yskidari dhe kadikoji në pjesën e Stambollit anadollian). Në Stamboll gjenden qindra objekte luksi dhe turizmi, si dhe objekte kulturi të besimit, veçanërisht të ngritura nga viti 1453 deri me rënien e kalifatit më 1923, por edhe në këtë shekullin e fundit, ku vetëm lagjja “Fatih” ka 340 xhami, ndërkohë që gjithë Stambolli ka rreth 3400 xhami. Stambolli është ndër qytetet më të populluar të planetit, që daton si kohë themelimi më 667 para erës sonë, në të dy anët e Bririt të Artë, një vend i mahnitshëm i ngrohtë dhe me hotele luksoze, një oazë, që i gjen të gjitha në zemër të metropolit, qytet i imazheve dhe befasive për vizitorët e botës.

Hoteli evropian “Pera palace” tek “mesi i botës” edhe “pronë” e shqiptarëve!

“Pera palace” në Stamboll është 130 vjeçar dhe mjaft i njohur në qytetin e dy kontinenteve dhe tre perandorive, në qytetin e kontrasteve, vlerave tradicionale, në qytetin e historisë. Hoteli është përmbushja e dëshirave të botës, me portat drejt bukurive të çmuara, që vizitorët e botës e kanë pagëzuar si “kryeqytet i botës”, ura që lidh Evropën me Azinë, qytet i skutave të historisë, me metro që nga viti 1875, qytet i djegur disa herë, por sërish i ngritur gjithmonë dhe më i bukur. “Pera palace” është vendosur 7.4 km larg nga “kërthiza” e qytetit, 32 km nga Aeroporti “Mustafa Atatürk”. Hoteli ndodhet në zonën “Tepebashë” të lagjes “Beyoglu”, që tradicionalisht është quajtur si “Evropa e vogël”, ku zhvillohen aktivitete kulturore e sociale gjithëvjetore. Hoteli historik ‘Pera Palas’ i Stambollit u ndërtua për të famshmin “Orient Ekspres”, për pritjen e pasagjerëve që vinin në Stamboll me trenin luksoz Ekspres të Orientit, i cili në vitin 1888 nisej nga Parisi dhe mbërrinte në Stamboll pas një udhëtimi 80 orësh, në rreth 3000 kilometra nga stacioni Gare de l’Est i Parisit deri në Stamboll. Hoteli priste burokratë, artistë, aristokratë të nivelit të lartë, pasagjerët elitare evropianë që kërkonin cilësi evropiane në zemër të Stambollit. Ndërtimi i hotelit “Pera” (Pera Palas) filloi në 1892 dhe përfundoi më 1895, duke qenë mjaft komod për kohën sikurse edhe hotelet cilësore perëndimore. Pera është një fjalë me kuptime të ndryshme në disa gjuhë të botës si para, monedhë, përtej, dardhë, vlerë e çmuar etj. Në këtë hotel-muze kanë qëndruar figura të politikës e sidomos të diplomacisë së Fuqive të Mëdha, bankierë, pronarë restorantesh, eksportues, hotelierë, ushtarakë të niveleve të larta, shkrimtarë si Agatha Christie, Alfred Hitchcock, Ernest Hemingëay e dhjetëra qindra të tjerë të shquar në fushën e letrave. Hotel “Pera Palas” është një nga ndërtesat madhështore të Stambollit dhe hoteli i parë



“PERA PALACE” NË STAMBOLL ËSHTË 130 VJEÇAR DHE MJAFT I NJOHUR NË QYTETIN E DY KONTINENTEVE DHE TRE PERANDORIVE, NË QYTETIN E KONTRASTEVE, VLERAVE TRADICIONALE, NË QYTETIN E HISTORISË. HOTELI ËSHTË PËRMBUSHJA E DËSHIRAVE TË BOTËS, ME PORTAT DREJT BUKURIVE TË ÇMUARA, QË VIZITORËT E BOTËS E KANË PAGËZUAR SI “KRYEQYTET I BOTËS”, URA QË LIDH EVROPËN ME AZINË, QYTET I SKUTAVE TË HISTORISË, ME METRO QË NGA VITI 1875, QYTET I DJEGUR DISA HERË, POR SËRISH I NGRITUR GJITHMONË DHE MË I BUKUR.

i Stambollit evropian me standarde evropiane, me energji elektrike, i pari me ashensor elektrik dhe ujë të ngrohtë, që u inaugurua më 1895 me një ballo speciale në hollin e tij. Duke qenë dëshmitare e shumë ngjarjeve të rëndësishme në Stamboll që nga Lufta e Parë Botërore, “Pera Palas” u bë pikë referimi në Turqi, dhe në platformat ndërkombëtare, ndërkohë që ka qenë dhe ka ngelur “kripa e gjellës në supën” e ekonomisë dhe kulturës popullore turke, fryma evropianiste e hotelierisë

evropiane në Stamboll. Një shekull më parë Stambolli kishte rreth 1200 restorante, por dhe një mundësi të konsiderueshme akomodimi, ku edhe shqiptarët kanë pasur dhe kanë pjesën e tyre të kontributit në zhvillimin e këtij qyteti modern, edhe pse duhet thënë se një shekull më parë qyteti me më së shumti shqiptarë në botë.

Çfarë ishte “Pera Palas” për shqiptarët dhe pavarësinë e shtetit shqiptar?



Në hotelin “Pera Palace” në Stamboll, më 1912 mblidhej gjithashtu ajka e mençurisë intelektualiste e mbarë shqiptarisë, atyre që trashëgonin vetitë më të mira të platformës së Shqipërisë të së nesërmes. Natyrisht nuk mungonin edhe çështjet komplekse si dhe nga ndonjëri edhe çështja e interesave. Ishte vendi ku “ndeshej” mendimi progresiv dhe mendimi konservator. Në këtë vend historik në “Pera Palas” në këtë ndërtesë të stilit klasik evropian të Stambollit, dikur kanë bujtur me dhjetëra njerëz të famshëm të botës. Pikërisht këtu u takuan Ismail Qemali, Hasan Prishtina, Syrja Vlora, Aziz Vrioni, Myfit Libohova dhe Esat Toptani për të diskutuar për Pavarësinë e Shqipërisë. Në dokumentet fotografike gjejmë edhe një fotografim të realizuar nga patrioti i shquar shqiptar Hasan Prishtina i cili e ka realizuar në vitin e pavarësisë më 1912. Për shqiptarët është fakt historik se nga hoteli historik “Pera Palas” i Stambollit, nisi rrugëtimi i Pavarësisë së shtetit shqiptar, të Ismail Qemal bej Vlorës. Ndër njerëzit e famshëm të Stambollit është dhe vlonjati (Avlonyali) Ismail Kemal beu. Në axhendën historike të kombeve “Pera Palas” është edhe “pronë” e shqiptarëve, një pikë e rëndësishme historike në formën e një pelegrinazhi për arsye se, prej këtij hoteli filloi rrugëtimi i Ismail Qemal Vlorës 68-vjeçar, që çoi në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë, më 28 nëntor 1912. Pera Palas ngeli përjetësisht në kujtesën e shqiptarëve si pikënisja e Pavarësisë, si vend pelegrinazhi, si stacioni ndër më të vizitueshmit të Arnautëve në qytetin e trëndafiltë, kaq të njohur dhe të dashur. Ndërkohë që në këtë qytet Sami Frashëri ose sikurse e thërrasin “birin e tyre” turqit e vjetër dhe të rinj “Shemsedin Sami” personalitetin e shquar të letrave turke dhe shqipe, pasi ai shkroi aq shumë për Shqipërinë e tij imagjinare dhe për Perandorinë Osmane reale, në këtë qytet, ku i biri i tij Ali Sami Jen, u bë president i një ekipi të njohur futbollit deri në ditët e sotme.

Ismail Qemali, Lauzanne, “Le Matin” dhe misioni i gazetarit
Misioni i gazetarit është i njohur në mbarë botën, sikurse edhe misioni i diplomatit, i atdhetarit por veçanërisht i shtetarit dhe shtetformuesit mendimtar dhe vizionar, që dinte të lexonte

aktualen dhe perspektivën. Por në kohë historike, kur definohen shtetet dhe vendoset e ardhmja e kombeve vlejné edhe më shumë dëshmitë e të gjitha llojeve, edhe ato gazetareske kur shkruhen me vërtetësi dhe që garantojnë besueshmëri. Gazetat dhe revistat evropiane, dhe jo vetëm, në kohën dhe vendin e duhur shkruan për Shqipërinë dhe shqiptarët. Në një pjesë të rëndësishme flitet e shkruhet edhe për fatin e kombit shqiptar. Edhe ideja dhe nisma për themelimin e shtetit të fundit në Ballkan ishte pjekur pikërisht në Stamboll. Prandaj edhe shkrimtarë, gazetarë, historian, kanë hedhur dritë e sigurisht do të vijnë në ndriçojnë një nga periudhat më shpresëdhënëse të kombit, përfshi këtu veçanërisht ata që janë thelluar në zbulimet që vijnë bazuar në dokumentacion autentik dhe që për ne janë dokumente RHK (dokumente me rëndësi historike kombëtare). Kështu sipas Ilir Ikonomit gazetarit dhe shkrimtarit historik “Në kujtim të Ismail Qemalit”, shkruan: “Në ‘Pera Palace’ shihje shpesh ato ditë të vitit 1912, një francez të shëndoshë, me flokë të zinj të ndarë në mes dhe me mustaqe të trasha. Ai ishte kryeredaktor i së përditshmes “Le Matin”, një prej gazetave më të njohura të botës dhe kishte ardhur nga Parisi për të mbuluar ngjarjet në Stamboll. Lauzanne njihej personalisht me Ismail bej Vlorën. Ndonjëherë mbrëmjeve, Ismaili i afrohej gazetarit dhe e pyeste fare shkurt: “Ndonjë të re?” Lauzanne i tregonte për humbjet dhe fitoret. Herë-herë, Ismail Qemali shprehte kënaqësi dhe thoshte vetëm kaq: “Sa mirë!” Në fytyrë nuk i shfaqej ndonjë emocion kushedi çfarë, pavarësisht se kush kishte humbur dhe kush kishte fituar. “Sa mirë!” përsëriste. Një ditë gazetari e pyeti: “Si ka mundësi që për ju është njëlloj mirë, si atëherë kur turqit fitojné ashtu edhe kur ata munden?”. Ismaili vuri buzën në gaz si rrallë ndonjëherë dhe me fjalë të qarta e të matura, tha: “Është mirë, sepse cilido qoftë fitimtari ose i munduri, ka ardhur ora që unë kam pritur gjithë jetën dhe që populli im ka pritur me shekuj: ora kur Shqipëria më në fund do të heqë zgjedhën dhe do të bëhet shtet i pavarur”. Stephane Lauzanne, fatmirësisht ka fiksuar në një shkrim të tij skenën e largimit të Ismailit nga Stambolli për të shkuar në Shqipëri. “Një mëngjes, - tregon ai, - takova Ismail Qemalin, i cili po nisej

me një torbë në dorë. Ishte e shtunë, 2 nëntor 1912. Ku po shkoni kështu? – e pyeta. - Do të marr vaporin. Do të shkoj në Shqipëri, – tha”. Ismaili dhe njerëzit e tij do të niseshin me anijen rumune “Regele Carol”, që bënte rregullisht rrugën Stamboll-Konstancë. Anija mbante emrin e mbretit të Rumanisë, me të cilin Ismaili ishte njohur dekada më parë. Me të njëjtën anije do të niseshin edhe Nabi beu, ambasadori i Turqisë në Itali dhe Hilmi pasha, ambasadori në Austri. I pari shkonte për të vulosur paqen përfundimtare me Romën, pas humbjes së perandorisë në luftën për Tripolin. Tjetri do të bisedonte me Vjenën dhe do të kërkonte ndërhyrjen e fuqive për t’i dhënë fund përparimit të ushtrive ballkanike. Të dy negociatorët kishin me vete valixhe të mëdha, kujton Lauzanne. Por bagazhi më i rëndë për nga shpresat dhe nga vendosmëria ishte ai brenda torbës së vogël të Ismail Qemalit”. (sipas librit të Ilir Ikonomit “Pavarësia, udhëtimi i paharruar i Ismail Qemalit”. Për “Pera Palas” është folur dhe do të flitet, pasi nga ky hotel është pelegrinazhi patriotik për shqiptarët. Këtu nisi rrugëtimi real drejt Pavarësisë së Shqipërisë, pasi në këtë hotel shkuan dhe qëndruan njerëz të famshëm por mbi të gjitha kaluan net e ditë njerëz me vlera për kombet sikurse ishte Ismail Qemali që kishte marrë mbi supe një ndër barrët më të rënda dhe më të vështira të historisë, atë të shpalljes së shtetit të pavarur shqiptar. Edhe plani i shpalljes së Pavarësisë shqiptare e ka zanafillën pikërisht në këtë hotel të famshëm europianist në Stamboll. Planu u thur dhe u programua nga Ismail Qemali dhe Hasan Prishtina, më 12 janar 1912, pasi ky i fundit një ditë më herët, kishte mbajtur një fjalim të fuqishëm në emër të grupit të deputetëve shqiptarë në seancën plenare që u mbajt në Parlamentin Osman. Prej këtu, vendosën të përfshinin në planin e tyre edhe deputetët e tjerë shqiptarë, duke u mbledhur një ditë më vonë, më 13 janar 1912, në shtëpinë e Syrja bej Vlorës, i cili ishte deputet i mexhlisit (kuvendit) osman e kushëri i dytë i Ismail Qemalit, që gjendej afër sheshit “Taksim” jo larg prej “Pera Palace”. Në takimin e Taksimit bashkë me deputetin e Beratit Aziz Pashë Vrioni, të Gjirokastrës Myfid bej Libohova dhe të Durrësit Esad pashë Toptani, të gjithë lidhën besën, duke u betuar mbi Kuran se do të ngrinin në revoltë popullsinë e zonës ku kishin ndikim. Kjo mbledhje e ky betim njihet në histori si pikë kthese me emrin “Komploti/ Mbledhja e Taksimit”, që në fakt është një pakicë deputetësh edhe pse në Parlamentin Osman të asaj periudhe (1912) ishin 26 deputetë për nga gjaku shqiptar. Ismail Qemali e dinte mirë se “Pera Palace” shërbente edhe si qendër takimesh patriotike, por dhe qendër e spiunëve, si hotel i gjeneralëve britanikë, shkrimtarëve, tregtarëve të armëve, udhëtarëve të ndryshëm të Orientit në një ndër lagjet më të frekuentuara dhe të pëlqyera të Stambollit. “Pera Palace” ishte përshëndetja e fundit e Perëndimit përgjatë rrugës drejt Orientit, hoteli më i shkëlqyeshëm i llojit perëndimor në kryeqytetin e perandorisë osmane, që në fakt shtrihej në 8 milionë kilometra katrorë. Me këtë hotel Stambolli linte pas të kaluarën osmane dhe po katapultohej në kohëra moderne. Stambolli dhe veçanërisht ky hotel kishte parë edhe refugjatë, oficerë të larguar nga shërbimi, përjetoi fundosjen e Kalifatit, dëshmonte se jeta matej me orën e Parisit, Londrës dhe New York-ut. Në tranzicionin e pushtetit Mustafa Kemal Atatürk, adhures i kulturës perëndimore solli një imazh të ri të shekullarizmit, me identitetit të ri perëndimor, ku në fakt ky hotel ishte pranvera e parë perëndimore në Stambollin e “ndryshkur” nga çallma osmane e shekujve. Pesha e udhëtimit të babait të kombit ishte pasha e halleve të një kombi të tërë, pesha e pavarësisë shqiptare. Ismail Qemali që dikur para 112 vitesh qëndronte ulur në hollin e vogël të hotelit, nuk është më një “plak”, 68-vjeçar, që rrethet intelektuale të Stambollit dhe jo vetëm e thërrisnin “Avlonyali Ismail Kemal bej”, por një figurë përfaqësuese e mençurisë shqiptare që jetonte dhe pulsi i rrihte për ardhmërinë e kombit por dhe zemra ia donte një gjë të tillë. Përtej rehatisë së “Pera Palas”– it qëndronte një komb i tërë, prandaj dhe nisma e tij që nisi në këtë hotel ndonjë një rrugëtim prej 4122.5 kilometrash të gjatë në rrugëtimin me karrocë, me anije, me tren, sërish me anije dhe që përfundoi në Vlorë sërish me karrocë nëpër rrugët e përbaltura të Myzeqesë edhe duke fjetur dy net një në Çermë të Lushnjës dhe një tjetër në Libofsh të Fierit përpara se të mbërrinte në Vlorën e tij dhe përpara se të trupëzohej dhe të hynte në histori si vigani i flamurit kombëtar dhe themelues i shtetit të parë shqiptar.

Robotët po vijnë: Ushtria amerikane eksperimenton me luftën njeri-makinë

Dukej si një helikopter lodër, një dron i vogël i zi u ngrit mbi një grup ndërtesash prej qerpiçi në një fshat të qetë të shkretëtirës, duke lëshuar një zhurmë të dobët. Droni, një “Ghost-X” i “Anduril Industries”, ndaloi dhe më pas u ngrit më lart, duke u zhdukur në re. Një tjetër pasoi.

Në dukje të vegjël dhe jo kërcënues, dronët po shërbenin si sytë e një kompanie këmbësorie të fshehur nga malet përreth dhe që po përgatiteshin për të rimarrë një fshat të mbajtur nga armiku. Dhe ata dronë nuk ishin vetëm.

Menjëherë, një grup makinerish luftarake me bazë ajrore dhe tokësore shpërtheu në skenë. Një “oktokopter” kaloi nëpër qiell me municione precize dhe robotë të tjerë të bashkangjitur në bark, duke hedhur tre fishekë mortajash 60 mm në një çati dhe “hedhës” të tjerë të vegjël, të dorës, cilindrikë në tokë.

Mjetet luftarake robotike dolën në pamje, të armatosura me mitraloza të kalibrit 50 dhe M240, duke qëlluar mbi pozicionet e armikut dhe duke siguruar mbulim për trupat që manovronin në fshat. Ndërkohë, një robot qen me katër këmbë doli nga një re e dendur tymi, duke u dhënë ushtarëve që vëzhgonin nga larg një pamje tjetër.

Skena ishte kulmi i një përpjekjeje të ushtrisë amerikane për të kuptuar se si mund të përdorë njerëzit dhe makinat së bashku në fushën e betejës. Udhëheqësit e shërbimit zbritën në Fort Irwin, Kaliforni - shtëpia e Qendrës Kombëtare të Trajnimit - në mars për një stërvitje të madhe të njohur si “Projekti Konvergjencia”. Demonstrimi ishte një paraqitje e shkurtër e së ardhmes së ushtrisë, sipas zyrtarëve të lartë. Gjenerali James Rainey, i cili drejton Komandën e Ardhshme të Ushtrisë, pret që forcat e ardhshme të shërbimit të integrohen aq shumë me makinat sa që njerëzit do të përballen me një rrezik shumë më të ulët. “Ne kurrë nuk do të përballim ushtarët tanë në vijë të parë” thotë ai shpesh, duke premtuar se do të vendosë robotë në vend të tyre. Por marrja e duhur e këtyre formacioneve nuk do të jetë e lehtë, pranojnë udhëheqësit. Që integrimi njeri-makinë të funksionojë, një rrjet funksional dhe miqësor për përdoruesit duhet ta mbështesë atë, ai kërkon mbrojtje nga sulmet kibernetike dhe sistemet duhet të kenë autonominë e duhur.

Udhëheqësit thonë gjithashtu se nuk është teknologjia që do të jetë faktori më i vështirë, por përkundrazi shpërndarja nga proceset e vjetra të blerjes që parandalojnë blerjet e shpejta dhe ngadalësojnë dërgesat për ushtarët.

“Ritmi i kërcënimit dhe ritmi i teknologjisë - evolucioni është shumë më i shpejtë, dhe nuk ka asnjë mënyrë që ne të kemi sukses nëse vazhdojmë të fitojmë teknologjinë ose madje zgjedhim ta zhvillojmë atë” me ritmin e zakonshëm, Joseph Welch, Drejtori i Qendrës C5ISR të Ushtrisë, tha në ngjarjen e marsit.

Përparim përpara

Ushtrimi i Projektit Konvergjencia pasoi disa muaj përpjekjesh të fokusuara në integrimin e njerëzve dhe makinerive në formacionet e shërbimit. Ishte një shans për të parë se çfarë funksionon dhe çfarë jo ndërsa Ushtria e SHBA-ve përgatitet për një luftë kundër kundërshtarëve me aftësi të avancuara. Shërbimi këmbëngul se tani është gati të ecë përpara me formacionet e integruara njeri-makinë.

Kërkesa për buxhetin fiskal 2025 shënon herën e parë që Ushtria ka përfshirë financimin për këto formacione, të quajtura edhe H-MIF. Ajo po kërkon 33 milionë dollarë për hapin e parë, i cili siguron një aftësi fillestare të integrimit njeri-makinë për formacionet e këmbësorisë dhe të blinduar. Ushtria po eksperimentonte me të dyja në Projektin e Konvergjencës.

Shërbimi dëshiron që makinat në këto formacione të reja “të shkarkojnë rrezikun” dhe t’u ofrojnë ushtarëve “informacion shtesë për vendimmarrje”, sipas dokumenteve të buxhetit të shërbimit.

Zyra e Aftësive të Shpejta dhe Teknologjive Kritike të Ushtrisë po drejton përpjekjet për Komandën e së Ardhmes. Zyra po krijon prototipe duke përdorur programe dhe ngarkesa robotike ekzistuese ajrore dhe tokësore, duke përfshirë arkitekturën e përbashkët, komunikimin dhe aftësitë e rrjetit. Financimi i FY25, ka thënë Ushtria, do të financojë lëvizjen e koncepteve përmes prototipizimit si dhe do t’u mundësojë ushtarëve t’i vlerësojnë ato në ushtrime dhe eksperimente.

Në ngjarjen e Projektit të Konvergjencës, Ushtria përmbysi fushën e betejës me robotë, sensorë dhe makina të tjera të destinuara për të ndihmuar ushtarët në fluturime komplekse. Eksperimenti përfshinte robotë ajror dhe tokësor me ngarkesa të rikonfigurueshme, dronë të lidhur, sisteme kundër dronëve dhe një emetues ventriloquist që imiton trafikun e frekuencave radio për të ngatërruar armikun. Shërbimi përdori më shumë se 240 pjesë të teknologjisë, duke përfshirë aftësitë nga ushtritë aleate në MB, Kanada, Australi, Francë dhe Japoni.

Presioni për të transformuar

Vendimi për t’u mbështetur më shumë te robotët nuk është një zgjedhje, sipas Alexander Miller, i cili tani po shërben si shef i teknologjisë për shefin e shtabit të ushtrisë, gjeneralin Randy George. George dhe Miller të dy e panë eksperimentin në mars; Miller mbante një celular me një aplikacion që demonstronte kompletin e ri të sulmit taktik të ushtrisë. Aplikacioni mbivendos vendndodhjen e ushtarëve dhe robotëve, si dhe pozicionet e armikut në kohë reale. Integrimi i robotëve në formacione po përshpejtohet gjithashtu sepse “ka pasur një ndryshim kulturor”, tha Miller. “Kanë kaluar 12-18 muaj kur ne kemi ndaluar së trajtuar robotët si një shtim një për një për ushtarët dhe kemi filluar të themi: “Cilat janë gjërat e fshehta, të pista, të rrezikshme, përçarëse, që robotët mund të bëjnë në të vërtetë dhe nuk janë vetëm fuqi luftarake? Si t’i rrisim ato pa hequr një pushkë të vetme ose disa pushkatarë jashtë linjës për të kontrolluar një robot?” Në eksperimentin e marsit, për



shembull, ushtria dërgoi një robot tokësor me një ngarkesë të linjës për pastrimin e minave për t’u vendosur përgjatë linjave të armikut. Ndërsa lufton pushtimin rus, ushtria ukrainase po i përdor këto për të çarmatosur fushat e minuara dhe llogoret e armikut, por duke i transportuar ato me automjete me ekuipazh.

Në eksperiment, roboti qëlloi ngarkesën e linjës nga një lëshues i vogël. Linja nuk shpërtheu siç ishte menduar. Udhëheqësit e ushtrisë thanë se defektet janë të zakonshme dhe bërja e kësaj pune do të ofronte një mënyrë shumë më të sigurt për ushtarët për të pastruar fushat e minuara. Gjithashtu duke mundësuar modele të reja për integrimin njeri-makinë është përparimi i teknologjisë komerciale, sipas Welch. “Kjo është përshpejtuar jashtëzakonisht në shumë fusha të ndryshme teknike”, tha ai.

Inteligjenca artificiale po bëhet më e zgjuar; sensorët po bëhen më të vegjël, më të lehtë dhe më të gjithanshëm; zgjidhjet e lidhjes janë më të bollshme; dhe aftësitë e bazuara në ajër, tokë dhe hapësirë janë më të lehta për t’u përdorur.

Pengesat e ardhshme

Udhëheqësit e ushtrisë pranojnë se ka shumë punë përpara për të integruar robotët dhe ushtarët në fushën e betejës. Vetë eksperimenti ilustron “sa i ndërlikuar do të jetë... ku ne vërtet shtojmë opsione me kosto më të ulët dhe më të lira dhe ne rrëmojmë mjedisin



qëllimisht”, - tha Miller.

Në një moment gjatë Projektit të Konvergjencës, Ushtria u bllokua, duke bërë që një tufë dronësh miqësorë të binte nga qielli. Shërbimi e rregulloi problemin duke aktivizuar një aftësi që lejon menaxhimin inteligjent të rrugëzimit për Wi-Fi të tij, tha Miller.

Përtej sfidave teknike, tha George, Ushtria duhet të bindë Kongresin të ndryshojë procesin e prokurimit në mënyrë që shërbimi të fitojë ose përshtatë aftësitë brenda linjave më të gjera të financimit. Qëllimi, shpjegoi ai, është të jemi më të përgjegjshëm ndaj asaj që funksionon për ushtarët dhe të jemi në gjendje të blejmë me shpejtësi sasi të vogla të atyre pajisjeve.

Një fokus është në shënimin e sigurimit që Ushtria mund të ndryshojë sistemet pa pasur nevojë për autorizim riprogramimi ose fonde të reja. Mënyrat teknike dhe operacionale që Ushtria do të përdorë sot formacione të integruara njeri-makinë “nuk do të thotë se kështu do t’i përdorim dy vjet nga tani”, - tha Mark Kitz, zyrtari ekzekutiv i programit të shërbimit për komandën dhe kontrollin me komunikim-taktik. “Ne nuk e trajtojmë historikisht robotikën si një program softuerësh. Është me të vërtetë një program softuerik”, shpjegoi Kitz. “Pra, si t’i përdorim disa nga autoritetet tona unike të blerjes për të ndërtuar atë fleksibilitet përpara?”

Miller tha se një tjetër pengesë e mundshme është sigurimi i prodhimit të mjaftueshëm të komponentëve në SHBA. “Ne duhet të kemi komponentë që janë të miratuar dhe të vlefshëm dhe nuk kemi frikë t’i përdorim sepse ato janë bërë nga një kundërshtar”, - tha ai. Welch vuri në dukje se ushtria po punon me laboratorët e qeverisë amerikane për të adresuar disa nga shqetësimet e komponentëve. Shërbimi po punon gjithashtu nga brenda për të rinovuar qasjen e tij për gjetjen e aftësive.

“Ka një lidhje shumë më të ngushtë... jo vetëm nga jashtë me partnerët tanë të industrisë dhe palët e tjera kyçe të interesuara, pavarësisht nëse ka përfunduar në Capitol Hill ose lart në Zyrën e Sekretarit të Mbrojtjes, por edhe brenda”, - tha gjenerallejtënant John Morrison, zëvendës shefi i Shtabit të Ushtrisë i ngarkuar me komandën, kontrollin, komunikimin, operacionet kibernetike dhe rrjetet. “Ne kemi kërkesa për blerjen, me testues, dhe ata janë të gjithë të përqendruar rreth ushtarëve, duke marrë atë reagim të drejtpërdrejtë.” Benjamin Jensen, një bashkëpunëtor i lartë në qendrën për studime strategjike dhe ndërkombëtare, ku ai fokusohet në lojërat luftarake, tha se ai është “optimist” për integrimin njeri-makinë, por se mund të zgjasë më shumë sesa pret shërbimi.

Ja mosha maksimale që mund të jetojë një njeri

Me kalimin e moshës, me siguri vëreni ndryshime në trupin tuaj. Në veçanti, një nga ato ndryshime është në kohën tuaj të rikuperimit. Pavarësisht nëse është nga një stërvitje e vështirë, një natë pa gjumë ose një ditë e gjatë dhe stresuese, ka të ngjarë të vini re se ju shkakton një dëm më të madh fizikisht sesa 10, 20 ose 30 vjet më parë. Kjo ka të bëjë me aftësinë e trupit për t'u rikuperuar, e cila bie me kalimin e moshës. Përcaktimi i moshës maksimale deri në të cilën një qenie njerëzore mund të jetojë për aq kohë sa ai është i shëndetshëm gjatë gjithë kohës varet nga koha kur trupi thjesht nuk mund të shërohet më.

Shkencëtarët nga kompania bioteknike “Gero” me bazë në Singapor dhe Qendra Gjithëpërfshirëse e Kancerit “Roswell Park” në Buffalo, Nju Jork, përcaktuan se mosha maksimale që një qenie njerëzore mund të jetojë, pa sëmundje, është midis 120 dhe 150 vjeç.

Si e përcaktuan moshën maksimale

Ekipi hulumtues përdori një tregues të gjendjes dinamike të organizmit (DOSI) për të përcaktuar se sa elastik është trupi i njeriut. DOSI merr parasysh moshën, sëmundjen dhe faktorë të tjerë të stilit të jetesës. Të gjithë këta faktorë të kombinuar ndihmuan ekipin të vlerësonte se sa kohë mund të ishte gjallë një trup përpara se thjesht të mos mund të shërohej më nga ndonjë lloj tendosjeje.

“Llogaritja e elasticitetit bazuar në rrjedhat e të dhënave të aktivitetit fizik është zbatuar në aplikacionin “GeroSense” në iPhone dhe është vënë në dispozicion për komunitetin e kërkimit nëpërmjet API-së së bazuar në ueb”, shpjegoi Tim Pyrkov, autori i parë i studimit dhe kreu i projektit mHealth në Gero. Sipas të dhënave të tyre, një 40-vjeçar mund të shërohet plotësisht në rreth dy javë. Një 80-vjeçar, megjithatë, merr mesatarisht gjashtë javë. Nëse kjo prire vazhdon ndërsa njerëzit plaken, atëherë diku rreth 120 dhe 150 vjet, trupi i njeriut do të humbasë plotësisht aftësinë e tij për t'u rikuperuar.

Pse është i rëndësishëm ky hulumtim?

Të kuptuarit e moshës maksimale deri në të cilën një qenie

kundër plakjes. thotë prof. Andrei Gudkov, Ph.D., Sr. Zëvendës President dhe Kryetar i Departamentit të Biologjisë së Stresit Qelizor në Qendrën Gjithëpërfshirëse të Kancerit Roswell Park.

Studiuesit shpresojnë se puna e tyre do të ndihmojë në përmirësimin e plakjes së njerëzve

Ata duan të frymëzojnë teknologji të reja dhe ndërhyrje shëndetësore për të ndihmuar njerëzit jo vetëm të jetojnë jetë më të gjatë, por edhe më të mirë. “Hetimi tregon se shkalla e rikuperimit është një shenjë e rëndësishme e plakjes që mund të drejtojë zhvillimin e barnave për të ngadalësuar procesin dhe për të zgjatur jetëgjatësinë shëndetësore”, - tha David Sinclair, profesor i gjenetikës në Shkollën Mjekësore të Harvardit. Studimi është publikuar në revistën “Nature Communications”.

Implikimet e ardhshme të hulumtimit

Implikimet e këtij hulumtimi janë të gjera. Duke përcaktuar kufijtë e

jetëgjatësisë njerëzore, shkencëtarët mund të synojnë fusha specifike të kujdesit shëndetësor dhe mjekësisë për të inovuar trajtime që zgjasin jo vetëm jetëgjatësinë, por edhe jetëgjatësinë shëndetësore. Kjo mund të çojë në përparime në luftimin e sëmundjeve dhe kushteve kronike që prekin kryesisht popullatat e moshuara.

Për shembull, përparimet në mjekësinë e personalizuar mund të shfaqen, duke u fokusuar në faktorët unikë gjenetikë dhe mjedisorë që ndikojnë në procesin e plakjes së një individi. Kjo qasje e përshtatur mund të përmirësojë cilësinë e jetës për shumë njerëz, duke i lejuar ata të shijojnë vitet e tyre të mëvonshme me vitalitet dhe probleme minimale shëndetësore.

Konsideratat etike dhe ndikimi shoqëror

Ndërsa kërkimi shkencor i jetëgjatësisë së zgjatur është emocionues, ai gjithashtu ngre pyetje të rëndësishme etike dhe implikime shoqërore. Çështje të tilla si shpërndarja e burimeve, rritja e popullsisë dhe shpërndarja e barabartë e trajtimeve kundër plakjes duhet të shqyrtohen me kujdes.

Zgjatja e jetëgjatësisë mund të rëndojë sistemet sociale, duke përfshirë kujdesin shëndetësor, pensionet dhe kujdesin për të moshuarit, duke kërkuar reforma të rëndësishme politike. Për më tepër, ka pyetje filozofike në lidhje me dëshirën e zgjatjes së jetës njerëzore përtej kufijve të saj natyrorë dhe ndikimin e mundshëm në përvojën njerëzore. Trajtimi i këtyre shqetësimeve do të jetë vendimtar ndërsa shoqëria lundron mundësitë dhe sfidat e paraqitura nga përparimet në kërkimin e jetëgjatësisë.

Jo vetëm jetëgjatësia maksimale potenciale, por edhe mundësitë novatore

Si përfundim, kërkimi mbi jetëgjatësinë njerëzore jo vetëm që zbulon jetëgjatësinë maksimale të mundshme, por gjithashtu hap rrugën për risitë që mund të përmirësojnë cilësinë e jetës sonë ndërsa plakemi. Ndërsa shkencëtarët vazhdojnë të eksplorojnë këto mundësi, është thelbësore të merren parasysh implikimet më të gjera dhe të përgatiten për ndryshimet shoqërore që mund të pasojnë. Në fund të fundit, qëllimi është të ndihmojmë njerëzit të jetojnë më të shëndetshëm dhe më të lumtur në vitet e tyre të mëvonshme.



njerëzore mund të jetojë na ndihmon të kuptojmë më mirë procesin e plakjes në përgjithësi. Kjo mund të ndihmojë për të përmirësuar gjendjen ekzistuese dhe për të krijuar ndërhyrje të reja kundër plakjes në të ardhmen. Kjo do të thotë të ofrohen mënyra për të parashikuar dhe parandaluar sëmundjet për të ndihmuar më mirë njerëzit të ruajnë shëndetin e tyre më vonë. Në fund të fundit, do të thotë t'i ndihmohet njerëzit të jetojnë një jetë më të plotë dhe të lumtur, pavarësisht se në cilën dekadë janë.

“Kjo punë, për mendimin tim, është një zbulim konceptual, sepse përcakton dhe ndan rolet e faktorëve themelorë në jetëgjatësinë njerëzore - plakjen, e përcaktuar si humbje progresive e elasticitetit dhe sëmundjet e lidhura me moshën, si “ekzekutues të vdekjes” pasi humbja e elasticitetit shpjegon pse edhe parandalimi dhe trajtimi më efektiv i sëmundjeve të lidhura me moshën mund të përmirësojë vetëm mesataren, por jo jetëgjatësinë maksimale, nëse nuk janë zhvilluar terapi të vërteta





Gazeta
“USHTRIA”
uron
Gëzuar Vitin
e Ri 2025!

